

SI FUNKSIONON BASHKIMI EVROPIAN

Udhërrëfyesi juaj
për institucionet e BE-së



Bashkimi Evropian

SI FUNKSIONON BASHKIMI EVROPIAN

Udhërrëfyesi juaj për institucionet e BE-së

Këtë broshurë dhe sqarime të tjera të shkurta e të qarta mbi BE-në mund t'i gjeni në faqen e internetit:
ec.europa.eu/publications

Komisioni Evropian
Drejtoria e Përgjithshme për Komunikim
Publikimet
B-1049 Bruksel

Dorëshkrimi i përfunduar në korrik 2007
Ilustrimi në kopertinë: KE

Të dhënat e katalogimit gjinden në fund të publikimit

Luksemburg: Zyra për publikime zyrtare të Komuniteteve Evropiane, 2007

ISBN-13 978-92-79-11298-0

© Komitetet Evropiane, 2007
Riprodhimi është i autorizuar

E shtypur në Kosovë*

*nën Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të KB

Përmbajtja

Prezantimi i Bashkimit Evropian	3
Traktatet	5
Si i merr BE vendimet	7
Parlamenti Evropian :	
zëri i popullit	11
Këshilli i Bashkimit Evropian:	
zëri i shteteve anëtare	15
Komisioni Evropian:	
promovimi i interesit të përbashkët	21
Gjykata e Drejtësisë:	
mbështetje ligjit	26
Gjykata Evropiane e Auditorëve:	
shpenzim i arsyeshem i parave tua	29
Komiteti Ekonomik dhe Social :	
zëri i shoqërisë civile	31
Komiteti i Rajoneve:	
zëri i qeverisë rajonale dhe lokale	33
Banka Evropian për Investime:	
financimi i zhvillimit ekonomik	35
Banka Qendrore Evropiane:	
menaxhimi i euros	37
Ombudsmani Evropian :	
hetimi i ankesave tua	39
Mbikëqyrësi Evropian i të Dhënave:	
mbrojtja e privacisë tuaj	41
Agjencitë	43



Prezantimi i Bashkimit Evropian

Bashkimi Evropian (BE) është familje e shteteve demokratike Evropiane që punojnë së bashku për të përmirësuar jetën e qytetarëve të saj dhe për të ndërtuar një botë më të mirë.

Zenkat familjare dhe krizat e rastësishme i bëjnë kryetutitj e gazetave, mirëpo larg kamerave BE në fakt është një tregim shumë i suksesshem. Për vetëm gjysmë shekulli BE ka ofruar paqe dhe prosperitet në Evropë, një monedhë të vetme Evropiane (euro) dhe një 'treg unik' pa kufij ku mallërat, njerëzit, shërbimet dhe kapitali lëvizin lirshëm. BE është bërë fuqia më e madhe tregtare, dhe lider botëror në fushat si mbrojtja e mjedisit dhe ndihma për zhvillim. Andaj, nuk është për tu habitur pse numri i shteteve anëtare është rritur nga gjashtë në 27 anëtarë, ndërsa edhe vende të tjera dëshirojnë të bashkohen.

Suksesi i Bashkimit Evropian vjen si rezultat i mënyrës së pazakonshme të funksionimit të tij. E pazakonshme sepse shtetet që e përbëjnë BE-në (shtetet anëtare) mbesin shtete të pavarura sovraane por ato e bashkojnë sovranitetin e tyre në mënyrë që të marrin fuqi dhe ndikim në nivel botëror, të cilën asnjëra nuk do ta kishte vetëm me kapacitetin e tyre. Kjo megjithatë nuk e bën BE-në federatë sikur Shtetet e Bashkuara, por është shumë më shumë se një organizatë për bashkëpunim në mes të qeverive, sikur janë Kombet e Bashkuara. BE është në fakt unike.

Bashkimi i sovranitetit, në praktikë do të thotë se shtetet-anëtare përcjellin disa nga ingerencat e tyre vendimmarrëse institucioneve evropiane që ato kanë formuar, ashtu që vendimet për çështje specifike të interesit të përbashkët mund të merren në mënyrë demokratike në

nivel evropian.

Tre institucionet kryesore vendim-marrëse janë:

- Parlamenti Evropian, që përfaqëson qytetarët e BE-së dhe që në mënyrë direkte zgjedhet nga ata;
- Këshilli i Bashkimit Evropian, që përfaqëson shtetet anëtare;;
- Komisioni Evropian, që ka për qëllim të mbështesë interesin e Unionit si tërësi.

“Tekëndeshi institucional” prodhon politika dhe sjell ligje që zbatohen në gjithë BE-në. Në parim, është Komisioni ai që propozon ligjet e reja, por Parlamenti dhe Këshilli i miratojnë ato. Komisioni dhe shtetet anëtare pastaj i implementojnë ato, kurse Komisioni i fuqizon ato.

Gjykata e Drejtësisë është arbitri i fundit në kontestet lidhur me të drejtën Evropiane.

Gjykata e Auditorëve kontrollon financimin e aktiviteteve të Bashkimit Evropian.

Një numër i organeve tjera poashtu kanë rol në bërjen e BE-së funksionale:

- Komiteti Evropian Ekonomik dhe Social përfaqëson lojtarët ekonomik dhe social në shoqërinë civile të organizuar, sikur janë punëdhënësit dhe punëmarrësit, sindikatat dhe organizatat e konsumatorëve;
- Komiteti i Rajoneve përfaqëson autoritetet rajonale dhe lokale;
- Banka Evropiane për Investime financojnë investimet në projekte të zhvillimit ekonomik brenda dhe jashtë BE-së, dhe ndihmon bizneset e vogla nëpërmes Fondit Evropian të Investimeve;

- Banka Qendrore Evropiane është përgjegjëse për politikën monetare evropiane;
- Ombudsmani Evropian heton ankesat lidhur me keqadministrimin nga institucionet dhe organet e BE-së;
- Mbikëqyrësi Evropian i të Dhënave mbrohet privacinë e të dhënave tuaja personale. Për më tepër, agjencitë e specializuara kujdesen për detyra të caktuara teknike, shkencore dhe menaxheriale.

Fuqitë dhe përgjegjësitë e institucioneve të BE-së, dhe rregullat dhe procedurat që ato duhet ndjekur, janë të përcaktuara në Traktatet të cilat themeluan BE-në. Traktatet miratohen nga kryetarët dhe kryeministrit e të gjitha shteteve të BE-së dhe pastaj ratifikohen nga parlamentet e tyre.

Kapitujt në vijim përshkruajnë Traktatet, institucionet e BE-së dhe organet dhe agjencitë tjera, duke sqaruar se çfarë bën çdo entitet dhe si ndërveprojnë ato.



Ceremonia e nënshkrimit të Traktatit të Romës më 1957 nga gjashtë shtetet themeluese.



Traktatet

BE është e bazuar në katër Traktate:

- Traktati themelues i Bashkësisë Evropiane për Thëngjill dhe Çelik (BETÇ), që u nënshkrua më 18 prill, 1951 në Paris, hyri në fuqi më 23 korrik, 1952. Që nga 23 korriku, 2002, nuk vlen më.
- Traktati themelues i Bashkësisë Ekonomike Evropiane (BEE), që u nënshkrua më 25 mars, 1957 në Romë dhe hyri në fuqi më 1 janar, 1958. Shpesh i referuar si 'Traktati i Romës'.
- Traktati themelues i Bashkësisë Evropiane për Energji Atomike (Euratom), që u nënshkrua në Romë, së bashku me Traktatin për BEE.
- Traktati për Bashkimin Evropian (BE), që u nënshkrua në Maastricht më 7 shkurt, 1992 dhe hyri në fuqi më 1 nëntor, 1993. Shpesh i referuar si 'Traktati i Maastricht'.

BETÇ, BEE dhe Euroatom krijuan tre "bashkësitë evropiane", respektivisht sisteme të vendimarrjes së përbashkët për thëngjillin, çelikin, energjinë nukleare dhe për sektorët tjerë kryesorë të ekonomive të shteteve-anëtare. Institucionet e bashkësisë, të formuara për të menaxhuar me këto sisteme, u bashkuan në vitin 1967, që rezultoi me një Komision të vetëm dhe një Këshill të Ministrave.

BEE, përveç rolit të saj ekonomik, gradualisht mori përsipër një numër të madh të përgjegjësiave, përfshirë politikën sociale, të mijedistit dhe atë rajonale. Pasi që më nuk ishte vetëm bashkësi ekonomike, traktati i

katërt (i Maastricht) e riemëroi këtë bashkësi thjeshtë si "Komuniteti Evropian" (KE). Pasi që Traktatit BETÇ po i afrohej fundit në 2002, përgjegjësitë për thëngjill dhe çelik në mënyrë progresive u shkruanë në Traktatet tjera.

Në Maastricht, qeveritë e shteteve anëtare promovuan forma të reja bashkëpunimi mes qeverive të shteteve-anëtare, për shembull në fushën e "drejtësisë dhe qësh-tjeve të brendshme". Duke ia shtuar këtë bashkëpunim ndërqeveritar sistemit ekzistues të "Bashkësisë", Traktati i Maastricht krijoi një strukturë të re me tre "shtylla", që është strukturë politike por edhe ekonomike. Ky është Bashkimi Evropian (BE).

Traktatet janë themel për çdo gjë që bën Bashkimi Evropian. Ato janë ndryshuar çdoherë kur shtetet të reja i janë bashkangjitur BE-së. Herë pas herë Traktatet janë ndryshuar



Bashkimi Evropian është i bazuar në traktatet e saj. Tri 'shtyllat' e saj përfqesojnë politika të ndryshme me sistem të ndryshëm të vendim-marrjes.



për të reformuar institucionet e BE-së dhe për t'ju dhënë përgjegjësi të reja. Çdoherë kur traktatet duhen të shqyrtohen dhe ndryshohen, kjo bëhet në konferencë të veçantë të qeverive nacionale të BE-së ("konferencë ndërqeveritare" ose KN). Konferencat kryesore kanë rezultuar me

- Akti Unik Evropian (AUE) është nënshkruar në shkurt të vitit 1986 dhe hyri në fuqi më 1 korrik, 1987. Ndryshoi Traktatin e BEE dhe hapi rrugën për formim të tregut unik;
- Traktati i Amsterdamt u nënshkrua më 2 tetor, 1997 dhe hyri në fuqi më 1 maj, 1999. Zgjeroi ndarjen e sovranitetit në më shumë fusha duke përfshirë më shumë të drejta të qytetarëve, dhe ndërveprim më të afërm mbi politikën sociale dhe ato të punësimit;

→ Traktati i Nicos, i nënshkruar më 26 shkurt, 2001, hyri në fuqi më 1 shkurt, 2003. Edhe ky traktat bëri ndryshime traktateve tjera, duke i dhënë orientim sistemit institucional të BE, ashtu që të vazhdojë të funksionojë në mënyrë efektive pas valës së re të pranimit të shteteve-anëtare.

- Draft Traktati Kushtetues, i cili ishte aprovuar dhe nënshkruar në tetor 2004, por nuk hyri në fuqi sepse nuk u miratua nga të gjitha shtetet anëtare të BE-së.
- Traktati i Reformës, ishte aprovuar në prillim në 2007, por nuk do të fuqizohet deri sa të ratifikohet nga të gjitha shtetet anëtare.



Mjedisi i pastër është një nga fushat në të cilën shtetet anëtare të BE-së janë pajtuar ta bashkojnë sovranitetin e tyre.

Si i merr BE vendimet

Vendim-marrja në nivelin e Bashkimit Evropian përfshinë institucione të ndryshme të BE-së, dhe në veçanti:

- Parlamenti Evropian (PE),
- Këshilli i Bashkimit Evropian, dhe
- Komisioni Evropian.

Në përgjithësi është Komisioni Evropian ai që propozon legjislacionin e ri, por Këshilli dhe Parlamenti i miratojnë ligjet. Në disa raste, Këshilli mund të veprojë vetëm. Institucionet tjera poashtu kanë një rol për të luajtur.

Format kryesore të legjislacionit të BE-së janë direktivat dhe rregulloret. Direktivat krijojnë objektivë të përbashkët për të gjitha shtetet anëtare, por i lejojnë hapësirë autoriteteve nacionale të vendosin për formën dhe metodën e arritjes së asaj objektivë. Normalisht, shteteve anëtare ju jepen një apo dy vite për të implementuar një objektivë. Rregulloret zbatohen në mënyrë të drejtpërdrejtë në të gjithë BE-në sa më parë që hyjnë në fuqi pa ndonjë akt të mëtejshëm për shtetet anëtare.

Rregullat dhe procedurat për vendim-marrje në BE janë të përcaktuara në Traktate. Çdo propozim për ligj të ri Evropian duhet të jetë i bazuar në nen të caktuar të Traktatit, të referuar si 'baza ligjore' e propozimit. Kjo e përcakton se cila procedurë legjislative duhet të përcillet. Tri procedurat kryesore janë 'bashkë-vendimi', 'konsultimi' dhe 'pëlqimi'.

1. Bashkë-vendimi


Bashkë-vendimi është procedura që përdoret më së shumti në vendim-marrje në BE. Në procedurën e bashkë-vendimit, Parlamenti ndan fuqinë legjislative në mënyrë të barabartë me Këshillin.

Nëse Këshilli dhe Parlamenti nuk mund të pajtohen për ndonjë pjesë të caktuar të legjislacionit, atëherë nuk do të ketë ligj të ri. Procedura përcakton dy 'lexime' të njëpasnjëshme në secilin institucion. Nëse është arritur marrëveshja në këto lexime, ligji mund të kalohet. Nëse jo, i njëjti do të vihet para komitetit të pajtimit, i përbërë nga numri i barabartë i përfaqësuesve të Këshillit dhe Parlamentit. Pasi që ky komitet të ketë arritur një marrëveshje, teksti i pajtuar dërgohet prapë Parlamentit dhe Këshillit në mënyrë që ata ta miratojnë përfundimisht ligjin. Procedura e pajtimit po bëhet gjithnjë e më e rrallë. Shumica e ligjeve të kaluara në procedurën e bashkë-vendimit, në fakt, ose miratohen në leximin e parë ose në të dytin si rezultat i bashkëpunimit të mirë në mes të tri institucioneve.

Diagrami në vijim tregon procedurën në mënyrë të detajuar. Për më shumë informata shih

www.ec.europa.eu/codecision

Procedura e bashkë-vendimmarrjes



Tre 'këshillat': kush është kush?

Shumë lehtë mund të ngatërroheni për atë se cilat janë të gjitha këto organe evropiane, sidomos kur organe të ndryshme kanë emra shumë të ngjashëm, siç është rasti me këto tre "këshilla".

Këshilli Evropian

→ Këtë këshill e përbëjnë Kryetarët e Shteteve apo të Qeverive të të gjitha shteteve të BE-së, plus Kryetari i Komisionit Evropian. Varet nga sistemi politik i secilit shtet se a do të jetë pjesëmarrës kryetari dhe/apo kryeministri i shtetit. Në parim, Këshilli Evropian takohet katër herë në vjet për t'u dakorduar për politikën e përgjithshme të BE dhe për të shqyrtuar progresin e arritur. Ky organ paraqet organin më lartë të vendim-marrjes në Bashkimin Evropian dhe njëherësh ky është shkaku se pse mbledhjet e këtij këshilli shpesh quhen "samite".

Këshilli i Bashkimit Evropian

→ Ky institucion, më parë i njohur si Këshilli i Ministrave, përbëhet nga ministrat qeveritarë nga të gjitha shtetet e BE. Këshilli takohet rregullisht për të marrë vendime dhe për të kaluar miratuar ligje evropiane. Përkrahimi i plotë për punën dhe funksionimin e tij është dhënë më poshtë në këtë broshurë.

Këshilli i Evropës

→ Ky nuk është aspak institucion i BE. Është një organizatë ndërqeveritare që, mes tjerash, ka për qëllim t'i mbrojë të drejtat e njeriut, të promovojë diversitetin kulturor Evropian dhe të luftojë problemet sociale, siç janë paragjykimet racore dhe jo-toleranca. Këshilli u formua në vitin 1949 dhe një nga arrijetet e tij të para ishte që të hartoj Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Për t'ua bërë të mundur qytetarëve që t'i gëzojnë të drejtat e tyre të parapara me këtë Konventë, Këshilli formoi Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Këshilli i Evropës tani ka 47 shtete-anëtare, përfshirë të gjitha 27 shtetet e Bashkimit Evropian. Sella e tij është Palais de l'Europe në Strazburg (France) is the Palais de l'Europe in Strasbourg (France).

2. Konsultimi

- kërkojë amandamente shtesë.

Nëse Parlamenti kërkon amandamente shtesë, Komisioni do t'i marrë parasysh të gjitha ndërrimet që i sugjeron Parlamenti. Nëse pranon ndonjë nga këto sugjerime, do t'i dërgojë Këshillit një propozim të ndryshuar.

Vendimi përfundimisht mbetet me Këshillin, i cili ose e miraton propozimin e amendamentuar apo e ndryshon atë më tej. Në këtë procedurë, sikur edhe në tjerat, nëse Këshilli e ndryshon një propozim të Komisionit duhet ta

- aprovojë propozimin e Komisionit,

- refuzojë atë ose



Përkthyesit e BE-së luajnë rol kyç në funksionimin e Unionit

bëj një gjë të tillë në mënyrë unanime.

3. Pëlqimi

Procedura e pëlqimit do të thotë se Këshilli duhet të sigurojë pëlqimin e Parlamentit Evropian para se të merren vendime të caktuara që kanë rëndësi të madhe. Kjo procedurë është e njëjtë si në rastin e konsultimit, përveç që Parlamenti nuk mund të ndryshojë propozimin: ose duhet ta pranojë ose ta refuzojë atë. Pranimi ("pëlqimi") kërkon shumicë absolute në votim.

Procedura e pëlqimit më së shpeshti përdoret për marrëveshjet me vendet tjera, përfshirë marrëveshjet që parashohin anëtarësimin e vendeve të reja në BE.

Kush punon për institucionet e BE-së?

Shërbyesit civil të cilët punojnë për institucionet e BE-së vijnë nga vendet anëtare të BE-së. Ata mbulojnë një gamë të gjerë të aktivitetëve dhe aftësive, nga ato të vendim-marrësit dhe menaxherëve, tek ekonomistët, inxhinierët, juristët, linguistët, sekretarët dhe stafit mbështetës teknikë. Ata duhet të jenë në gjendje dhe të vullnetshëm të punojnë në mjedis shumë-kulturor dhe shumë-gjuhësor, rëndom në një distancë relativisht të largët nga shtëpia e tyre.

Për tu bërë shërbyes civil i BE-së ju duhet të kaloni një provim mjaft të vështirë dhe konkurrues. Këto provime janë të organizuar në mënyrë të centralizuar nga Zyra Evropiane e Personelit (EPSO).

Më shumë info në europa.eu/epso



Parlamenti Evropian: zëri i popullit

FAKTET KYÇE

ROLI //	Krah legjislativ i BE, i zgjedhur drejtpërdrejtë.
ZGJEDHJET E ARDHSHE ME//	Qershor 2009.
MBJEDHJET //	sesione plenare mujore në Strasburg, mbledhje komitetesh dhe sesione plotësuese në Bruksel.
ADRESA //	Plateau du Kirchberg, B.P. 1601, L-2929 Luksemburg.
TELEFONI //	(+352) 43001
INTERNET FAQJA //	europarl.europa.eu

Parlamenti Evropian (PE) zgjidhet nga qytetarët e Bashkimit Evropian për të përfaqësuar interesat e tyre. Origjina e tij daton që nga Traktatet themeluese të 1950-ve. Që nga 1979 anëtarët e tij janë zgjedhur në mënyrë të drejtpërdrejtë nga qytetarët e BE-së.

Zgjedhjet parlamentare mbahen çdo pesë vjet dhe çdo qytetar i BE që është i regjistruar si votues, ka të drejtë vote. Domethënë Parlamenti shpreh vullnetin demokratik të 500 milionë qytetarëve të BE-së dhe përfaqëson interesin e tyre gjatë bisedave dhe bashkëpunimit me institucionet tjera të BE.

Zgjedhjet e fundit janë mbajtur në qershor 2004. Parlamenti ka 785 anëtarë nga të gjitha 27 shtetet e BE-së.

Anëtarët e Parlamentit Evropian (APE) nuk ulen në blloqet nacionale, por në grupe politike mbarë-evropiane. Në mes tyre, ata përfaqësojnë të gjitha pikëvështrimet mbi çështjet politike dhe integrimin Evropian, nga pro-federalistët e fortë e deri tek Euroskeptikët.


Hans-Gert Pötinger është zgjedhur President i PE më 2007 dhe do ta mbajë atë post deri në zgjedhjet e vitit 2009.

Ku është i vendosur Parlamenti?

Parlamenti Evropian ka tri vende të punës: në Bruksel (Belgjikë), Luksemburg dhe në Strasburg (Francë).

Luksemburgu është qendra e zyrave administrative ("Sekretariati Gjeneral"). Sesionet plenare mujore të tërë Parlamentit mbahen në Strasburg dhe nganjëherë në Bruksel. Takimet e komiteteve mbahen poashtu në Bruksel.

Numri i ulëseve për grup politik, deri më 1 shtator 2007



Numri i ulëseve për vend

Austria	18	Letoni	9
Belgjikë	24	Lituani	13
Bullgari	18	Luksemburg	6
Cipro	6	Maltë	5
Republika Çeke	24	Holandë	27
Danimarkë	14	Poloni	54
Estoni	6	Portugali	24
Finlandë	14	Rumani	35
Francë	78	Slovaki	14
Gjermani	99	Sloveni	7
Greci	24	Spanjë	54
Hungari	24	Suedi	19
Irlandë	13	Mbetëri e Bashkuar	78
Itali	78	Gjithsej	785



Hans-Gert Pötering,
President i Parlamentit Evropian

Çfarë bën Parlamenti?

Parlamenti ka tre role kryesore:

1. Miratimin e ligjeve Evropiane - së bashku me Këshillin në shumë fusha të politikave. Fakti se PE zgjidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë, garanton legjitimitetin demokratik të ligjit Evropian.
2. Kryen mbikëqyrje demokratike mbi institucionet tjera të BE-së dhe në veçanti mbi Komisionin. Ka të drejtë të miratojë apo të refuzojë emërimet e komisionarëve, si dhe ka të drejtë ta shkarkojë tërë Komisionin.
3. Fuqia e parash. Së bashku me Këshillin ndan mandatin për buxhetin e BE-së dhe rishpërndan mandatin në ndikime të shpenzimit të BE. Në fund të procedurës, miraton ose refuzon buxhetin në tërësi.

Më detajisht, këto tre role janë të përshkruara më poshtë.

1. Miratimi i ligjeve Evropiane

Procedura më e rëndomtë për miratim të një tërësie ligjesh të BE është “bashkë-vendimi” (shih më lartë). Si i merr BE vendimet? Kjo procedurë lëvë Parlamentin Evropian dhe Këshillin në një pozitë të barabartë, dhe e aplikon në legjislacionin e shumë sferave.

Në disa fusha (për shembull bujqësi, politikë ekonomike, viza dhe migrim), Këshilli bën ligjvënien i vetëm, por duhet ta konsultojë Parlamentin. Për më tepër, pëlqimi i Parlamentit nevojitet për disa vendime të rëndësishme, sikur është anëtarësimi i vendeve të reja BE-së.

Parlamenti poashtu parashtron nevojën për legjislacion të ri, duke analizuar programin vijetor punues të Komisionit, duke marrë parasysh ligje të reja që do të ishin të përshtatshme dhe duke kërkuar nga Komisioni që të japë propozime.

2. Mbikëqyrje demokratike

Parlamenti kryen mbikëqyrje demokratike mbi institucionet tjera Evropiane në disa mënyra.

Kur zgjidhet Komisioni i ri, anëtarët e tij emërohen nga qeveritë e vendeve të BE-së, por ata nuk mund të zgjidhen pa miratimin e Parlamentit. Parlamenti interviston të gjithë anëtarët potencialë të rinj, përfshirë Kryetarin e Komisionit dhe pastaj voton mbi miratimin e Komisionit si tërësi.

Përgjatë mandatit të tij, Komisioni politikisht i jep llogari Parlamentit, i cili mund të paraqesë “mocion qortimi”, duke kërkuar dorëheqje nga të gjithë në Komision.


Në përgjithësi, Parlamenti rregullisht kryen kontroll duke analizuar raportet që i dërgohen nga Komisioni (raporti i përgjithshëm, raportet për implementimin e buxhetit, zbatimin e ligjit, etj.). Për më tepër, parlamentarët rregullisht i parashtrajnë Komisionit pyetje, të cilave Komisioni është i obliguar t’i përgjigjet.



Këshilli i Bashkimit Evropian: zëri i shteteve-anëtare

FAKTET KYÇE

ROLI //	Legislative (in some fields executive) arm of the EU; represents the member states.
ANËTARËT //	nga një ministër prej çdo shteti të BE-së
ZGJEDHJET E ARDHSHME //	One minister from each EU country
PRESIDENCY //	Rotacion çdo gjashtë muaj.
MBJEDHJET //	Në Bruksel (Belgjikë), përveç në prill, qershor dhe tetor, kur mbledhjet mbahen në Luksemburg.
ADRESA //	Rue de la Loi 175 Weistraat, B-1048 Bruksel
TELEFONI //	(+32-2) 285 61 11
INTERNET FAQJA //	consilium.europa.eu



Një poster i cili fton qytetarët e Luksemburgut të votojnë në zgjedhjet e para direkte për Parlamentin Evropian në vitin 1979.

Parlamenti poashtu mbikëqyr punën e Këshillit. Parlamentarët rregullisht i parashtrojnë Këshillit pyetje me shkrim dhe me gojë dhe Kryetari i Këshillit merr pjesë në sesionet plenare duke u inkadruar në debatet e rëndësishme.

Parlamenti mund të ushtrojë kontroll demokratik duke shqyrtuar peticionet e qytetarëve dhe duke formuar komisione të përkohshme për hetim.

Së fundi, Parlamenti parashtron çështje të shumta në çdo samit të BE (mbledhjet e Këshillit Evropian). Në hapjen e çdo samiti, Kryetari i Parlamentit është i ftuar t'i paraqesë qëndrimet dhe brengat e Parlamentit për çështje të cilat janë në agjendën e Këshillit Evropian.

3. Fuqia e parasë

Buxheti vjetor i BE vendoset bashkërisht nga Parlamenti dhe Këshilli. Parlamenti debaton për atë në dy shqyrtime të njëpasnjëshme dhe nuk hyn në fuqi deri sa nuk nënshkruhet nga Kryetari i Parlamentit.

Komiteti Parlamentar për Kontroll Buxhetor mbikëqyr si shpenzohet buxheti për çdo vit. Për më tepër, Parlamenti vendos çdo vit a të miratojë apo jo raportin e dorëzuar nga Komisioni për atë se si është shfrytëzuar buxheti vitin e kaluar fiskal. Ky proces miratimi teknikisht është i njohur si “vërtetimi dhe aprovimi i pagesave”.

Si është e organizuar puna e Parlamentit?

Puna e Parlamentit ndahet në dy faza kryesore:

- Përgatitje për seancat plenare. Kjo bëhet nga parlamentarët në komitetet e ndryshme parlamentare, që janë të specializuar për sfera të caktuara të aktivitetit të BE dhe mbi bazën e një raporti të përgatitur nga një anëtar i komitetit i ashtuquajtur ‘raportues’.
- Raporti ofron informata të nevojshme, si

Këshilli është organi kryesor vendimmarrës i BE-së. Ashtu si edhe Parlamenti Evropian, Këshilli u formua me traktatet themeluese në vitet e '50-ta. Ky këshill përfaqëson shtetet-anëtare dhe në mbledhjet e tij merr pjesë nga një ministër prej çdo qeverie nacionale të BE.

Se kush nga ministrat merr pjesë në mbledhjet e caktuara varet nga ajo se çfarë diskutohet në agjendë. Nëse, për shembull, Këshilli do të diskutojë çështje për mjedisin, në mbledhjet do të marrin pjesë ministrat e mjedisit nga çdo shtet i BE dhe ky këshill do të quhet “Këshilli i Mjedisit”.

Marrëdhëniet e BE-së me botën i udhëheq “Këshilli për Çështje të Përgjithshme dhe Marrëdhënie të Jashtme”. Por, ky Këshill poashtu ka përgjegjësi më të gjerë për çështjet e përgjithshme, kështu që në mbledhjet e tij merr pjesë ministër apo sekretar shteti që zgjedh çdo qeveri.

Në përgjithësi ka nëntë konfiguracione të

ndryshme të Këshillit:

- Këshilli për Çështje të Përgjithshme dhe Marrëdhënie të Jashtme
- Këshilli për Çështje Ekonomike dhe Financiare (ECOFIN)
- Këshilli për Drejtësi dhe Çështje të Brendshme
- Këshilli për Punësim, Çështje të Politikës Sociale, Shëndetësisë dhe Konsumatorëve
- Këshilli për Konkurrencë (tregu i brendshëm, industria dhe hulumtime)
- Këshilli për Transport, Telekomunikim dhe Energji
- Këshilli për Bujqi dhe Peshkari
- Këshilli i Mjedisit
- Këshilli për Edukim, Rini dhe Kulturë.

Çdo ministër në Këshill përfaqëson qeverinë e tij/saj. Me flajë tjera, nënshkrimi i ministrit

nënkupton miratim nga e tërë qeveria që përfaqëson ministri. Për më tepër, çdo ministër në Këshill i përgjigjet parlamentit të tij/saj nacional dhe qytetarëve që i përfaqëson ai parlament. Së bashku me përshirjen e Parlamentit Evropian në vendim-marrje, kjo mundëson legjitimitet demokratik të vendimeve të Këshillit.

Deri katër herë në vit kryetarët dhe/apo kryeministrit e vendeve të BE-së, së bashku me Kryetarin e Komisionit Evropian takohen me Këshillin Evropian. Këto 'samit' takime i përcaktojnë politikat e përgjithshme të BE-së dhe zgjidhin çështje që nuk kanë mundur të zgjidhen në nivel më të ultë (p.sh. nga ministrit në takimet e rregullta të Këshillit). Për shkak të rëndësisë së diskutimeve të Këshillit Evropian, ato shpesh zgjasin deri natën vonë dhe tërheqin vëmendjen e mediave.

Cfarë bën Këshilli?

Këshilli ka gjashtë përgjegjësi kyçe:

1. Të miratojë ligjet evropiane. Në shumë sfera këtë e bën së bashku me Parlamentin Evropian.
2. Të koordinojë politikat ekonomike dhe sociale të shteteve-anëtare.
3. Të realizojë marrëveshje ndërkombëtare mes BE-së dhe një ose më shumë shteteve apo organizatave ndërkombëtare.
4. Të aprovojë buxhetin e BE, së bashku me Parlamentin Evropian.
5. Të zhvillojë Politikën e Përbashkët të Jashtme dhe të Sigurisë të BE (për më shumë detaje, shih më poshtë), duke u bazuar në parimet udhëzuese të Këshillit Evropian.
6. Të koordinojë bashkëpunimin mes gjykatave nacionale dhe forcave policore lidhur me çështjet e krimit.

Shumica e këtyre përgjegjësiave kanë të bëjnë me ato sfera ku shtetet-anëtare kanë vendosur ta bashkojnë sovranitetin e tyre dhe i japin

institucioneve të BE autorizime dhe ingjencia vendimmarrëse. Kjo sferë paraqet "shtyllën e parë" të Bashkimit Evropian. Ky domen është 'shtylla e parë' e Bashkimit Evropian.

Mirëpo, dy përgjegjësitë e fundit kanë të bëjnë më shumë me sferat nga të cilat shtetet-anëtare nuk kanë hequr dorë nga vendimmarrja, por thjesht vetëm punojnë së bashku. Kjo quhet "bashkëpunim ndërqeveritar" dhe mbulon "shtyllën" e dytë dhe atë të tretë të Bashkimit Evropian.

Më detajisht puna e Këshillit përshkruhet më poshtë.

1. Legjislacioni

Puna më e madhe e Këshillit është në procedimin e legjislacionit në sferat ku BE ka zgjeruar sovranitetin e saj. Procedura më e shpeshtë për këtë është 'bashkë-vendimi', ku legjislacioni i BE-së miratohet bashkërisht nga Këshilli dhe Parlamenti mbi bazën e një propozimi nga Komisioni. Në disa fusha, Këshilli ka fjalën kryesore mirëpo vetëm mbi bazën e një propozimi nga Komisioni dhe vetëm pasi të merr parasysh qëndrimet e Komisionit dhe Parlamentit (shih më lartë 'Si i merr BE vendimet').

2. Koordinimi i politikave të shteteve anëtare

Shtetet e BE-së kanë vendosur se duan politikë të përbashkët ekonomike, që bazohet në bashkëpunim të ngushtë mes politikave të tyre nacionale ekonomike. Ky bashkëpunim realizohet nga ministrit e ekonomisë dhe financave, që së bashku formojnë Këshillin për Çështje Ekonomike dhe Financiare (ECOFIN).

Ata poashtu duan të krijojnë më shumë vende pune dhe të përmbledhojnë edukimin e tyre, sistemin e mbrojtjes shëndetësore dhe sociale. Edhe pse çdo vend i BE-së është përgjegjës për politikën e vet në këto fusha, ata mund të pajtohen mbi qëllimet e përbashkëta dhe të mësojnë nga përvojat e njëri tjetrit se çka funksionojnë shumë. Ky proces quhet 'metoda e hapur e



Havier Solana, shefi i marrëdhënieve të jashtme të BE-së, mëson nga përvojat e refugjatëve

koordinimit", dhe ndodhë brenda Këshillit.

3. Realizimi i marrëveshjeve ndërkombëtare

Çdo vit Këshilli "realizon" (respektivisht, zyrtarisht nënshkruan) një numër të marrëveshjeve mes Bashkimit Evropian dhe shteteve tjera, si dhe me organizata ndërkombëtare. Këto marrëveshje janë të sferave të ndryshme, siç janë tregtia, bashkëpunimi dhe zhvillimi ose kanë të bëjnë me çështje të caktuara, siç janë tekstili, peshkataria, shkenca dhe teknologjia, transporti etj.

Këshilli poashtu mund të arrijë marrëveshje mes shteteve-anëtare të BE-së në sfera, siç janë tatimi, ligji për ndërmarrje ose mbrojtja konsulare. Marrëveshjet ndonjëherë kanë të bëjnë edhe me bashkëpunimin në sferën e drejtësisë dhe çështjeve të brendshme (shih më poshtë).

4. Miratimi i buxhetit të BE-së

Buxheti vjetor i BE aprovohet bashkërisht nga Këshilli dhe Parlamenti Evropian.

5. Politika e Përbashkët e Jashtme dhe e Sigurisë

Shtetet-anëtare angazhohen që të zhvillojnë Politikë të Përbashkët të Jashtme dhe të Sigurisë (PPJS). Por politika e jashtme, siguria dhe mbrojtja janë çështje për të cilat shtetet-anëtare të BE-së kanë kontroll të pavarur. Sidoqoftë, shtetet e BE-së mund të përfitojnë shumë duke punuar së bashku në këto çështje dhe Këshilli është forumi kryesor ku ndodh ky "bashkëpunim ndërqeveritar".

Ky bashkëpunim mbështetë jo vetëm çështjet e mbrojtjes por edhe detyra të menaxhimit të krizave, sikur janë operacionet humanitare dhe ato të shpëtimit, mbajtja e paqes dhe bërja e paqes në vendet e krizave. Vendet e BE-së tentojnë të mobilizojnë dhe koordinojnë forcat ushtarake dhe policore, në mënyrë që ato të përdoren në koordinim me veprimet diplomatike dhe ekonomike. Njëpërmas këtyre mekanizmave, BE ka ndihmuar mbajtjen e paqes, ndërtimin e demokracisë dhe rritjen e progresit ekonomik në vendet të largëta si Indonezia, Republika Demokratike e Kongos dhe vende të Evropës

jug-lindore.

6. Liria, siguria dhe drejtësia

Qytetarët e BE-së janë të lirë të jetojnë dhe punojnë në cilin vend të BE-së që duan, dhe në këtë mënyrë ata duhet të kenë qasje të barabartë në drejtësinë civile çdo kund në Bashkimin Evropian. Gjykata nacionale prandaj duhet të punojnë së bashku që të sigurojnë se, për shembull, vendimi i lëshuar nga gjykata e një vendi të BE-së lidhur me rastin e shkurorëzimit apo kujdestarisë mbi fëmijën duhet të njihet në të gjitha vendet tjera të BE-së.

Liria e lëvizjes brenda BE-së është e një dobie të madhe për qytetarët që e respektojnë ligjin, por poashtu është eksploatuar nga kriminelët ndërkombëtarë dhe terroristët. Për të adresuar krimin ndër-kufitar kërkohet bashkëpunim në mes të gjykatave vendore, forcave policore, zyrtarëve të doganave dhe shërbimeve të migrimit të të gjitha vendeve të BE-së.

Ata duhet të sigurojnë, për shembull:

- që kufijtë e jashtëm të BE-së janë të kontrolluar nga policia në mënyrë efektive;

- që zyrtarët doganorë dhe policia të shkëmbejnë informacione mbi lëvizjen e trafikantëve të dyshuar të drogës apo trafikantëve të qenieve njerëzore;

- që azil-kërkuesit janë vlerësuar dhe trajtuar në mënyrë të njëjtë nëpër tërë BE-në, në mënyrë që të parandalohet 'shopingu i azil-kërkuesve'.

Çështjet si këto trajtohen nga Këshilli i Drejtësisë dhe Çështjeve të Brendshme — p.sh. ministrit për drejtësi dhe për punë të brendshme. Me këtë mëtohet të krijohet një zonë e vetme për 'fushën e lirisë, sigurisë dhe drejtësisë' brenda kufijve të BE-së.

Si është e organizuar puna e Këshillit?

Presidenca e Këshillit

Presidenca e Këshillit bëhet me rotacion në çdo gjashtë muaj. Me fjalë tjera, çdo vend i BE-së merr udhëheqjen e agjendës së Këshillit dhe drejton të gjitha takimet për një periudhë gjashtë mujore, duke promovuar kështu vendimet legislative dhe politike dhe



Lëvizja e lirë e njerëzve dhe mallërave brenda BE-së kanë bërë që kontrollet kufitare si këto gjatë udhëtimit në Evropë të jenë një dukuri e kaluarës

duke ndërmjetësuar kompromise në mes të shteteve anëtare.

Sekretariati Gjeneral

Kryesinë e asistion Sekretariati Gjeneral, që përgatit dhe siguron funksionim të rrjedhshëm të Këshillit dhe punës së tij në të gjitha nivelet.

Në vitin 2004, z. Javier Solana u ri-emërua Sekretar Gjeneral i Këshillit. Ai është edhe Përfaqësues i Lartë i Politikës së Përbashkët të Jashtme dhe të Sigurisë (PPJS), duke ndihmuar kështu të koordinojë veprimet e BE-së në aspektin global.

Sekretari Gjeneral asistohet nga Zëvendës Sekretari Gjeneral, i cili është përgjegjës për menaxhim dhe udhëheqje të Sekretariatit Gjeneral.

COREPER

Në Bruksel, çdo shtet-anëtar i BE-së në vazhdimësi ka ekip ("representacion"), që përfaqëson dhe mbrojnë interesat e veta nacionale në nivel të BE. Udhëheqësi i çdo ekipi përfaqësues është kryes detyrë ambasador i shtetit të tij/saj në BE.

Këta ambasadorë (të quajtur "përfaqësues të përhershëm") takohen çdo javë në mbledhjet e Komitetit të Përfaqësuesve të Përhershëm (COREPER). Roli i këtij komiteti është të përgatisë punën e Këshillit, me përjashtim të çështjeve të bujqësisë, të cilat i mbulon Komiteti Special për Bujqësi. KPP asistohet nga një numër grupeesh punuese, të përbëra nga zyrtarë të administratave nacionale.

Siguria dhe mbrojtja

Këshilli asistohet nga një strukturë e ndarë në çështjet e sigurisë dhe mbrojtjes:

- Komiteti për Politikë dhe Siguri (KPS), që është për këtë bashkëpunim sikur Coreper-i për llojet tjera të vendimeve;

- Komiteti Ushtarak i Bashkimit Evropian (KUBE), i përbërë nga Shefat e Stafit të Mbrojtjes së shteteve anëtare; dhe

- Staf i Ushtarak i Bashkimit Evropian (SUBE), i përbërë nga ekspertët ushtarakë dhe civilë të dërguar tek Sekretariati i Këshillit nga shtetet anëtare;

- Komiteti për Aspektet Civile të Menaxhimit të Krizave.

Sa vota ka çdo shtet?

Në Këshill vendimet merren me votim. Sa më i madh të jetë numri i banorëve të një shteti, aq më shumë vota ka ai shtet në Këshill, por ky numër është në favor të shteteve me numër më të vogël të banorëve:

Francë, Gjermani, Itali dhe Mbretëri e Bashkuar	29
Poloni dhe Spanjë	27
Rumani	14
Holandë	13
Belgjikë, Republika Çeke, Greqi, Hungari dhe Portugali	12
Austri, Bullgari, Suedi	10
Danimarkë, Finlandë, Irlandë, Lituani dhe Sllovaki	7
Qipro, Estoni, Letoni, Luksemburg dhe Slloveni	4
Malitë	3
Gjithsej	345

Votimi i shumicës së kualifikuar

Në disa çështje veçanërisht të ndjeshme sikur politika e përbashkët e jashtme dhe e sigurisë, tatimimi, azili, dhe politika e migrimit, vendimet e Këshillit duhet të jenë unanime. Me fjalë të tjera, në këto sfera çdo shtet-anëtar ka të drejtën e vetos.

Megjithatë, në shumicën e çështjeve Këshilli i merr vendimet me 'votimin e shumicës së kualifikuar'.

Shumica e kualifikuar arrihet:

- Nëse shumica e shteteve anëtarë e miratojnë (në disa raste shumica prej dy të tretave); dhe
- Nëse minimumi prej 255 votave është në favor — që përbën 73.9% të votave të përgjithshme.

Poashtu një shtet anëtar mund të kërkojë për konfirmim se votat në favor (pro) paraqesin së paku 62% të popullatës së përgjithshme të Bashkimit Evropian. Nëse nuk arrihet kjo përqindje, vendimi nuk do të miratohet.



Komisioni Evropian: avancim i interesit të përbashkët

FAKTET KYÇE

ROLI //	Krah ekzekutiv i BE dhe iniciator i propozimeve legislative
ANËTARËT //	27: një përfaqësues nga çdo shtet anëtarë
MANDATI //	Pesë vite (2004–09)
ADRESA //	B-1049 Bruksel
TELEFONI //	(32-2) 299 11 11
INTERNET FAQJA //	ec.europa.eu



BE-ja ndihmon trajnimin dhe zhvillimin e policisë në rajonet e trazuara, duke theksuar rëndësinë e marrëdhënieve të mira ndër-komunitare.

Komisioni është institucion i pavarur politikisht nga qeveritë e shteteve. Roli i tij është të përfaqësojë dhe mbështesë interesat e BE-së në përgjithësi. Komisioni harton propozime për ligje të reja Evropiane, të cilat ia paraqet Parlamentit Evropian (PE) dhe Këshillit.

Është poashtu krah ekzekutiv i BE-së — me fjalë të tjera është përgjegjës për implementimin e vendimeve të Parlamentit dhe Këshillit. Kjo nënkupton menaxhimin e përditshëm të Bashkimit Evropian: implementimin e politikave të tij, udhëheqjen e programeve dhe shpenzimin e fondeve.

Ashtu si edhe Parlamenti dhe Këshilli, Komisioni Evropian u formua në vitet e 1950-ta me Traktatet themeluese të BE-së.

Kush është Komisioni?

Termi 'Komision' përdoret në dy kuptime. Së pari, i referohet "Anëtarëve të Komisionit", respektivisht ekipit të përbërë nga njëzet burra dhe gra, të emëruar nga shtetet-anëtare për

të udhëhequr institucionin dhe për të marrë vendime. Së dyti, termi "Komision" i referohet vet institucionit dhe personelit të tij.

Joformalisht, Anëtarët e Komisionit janë të njohur si "komisionarë". Të gjithë ata i kanë mbajtur pozitat e veta politike në shtetet e tyre dhe mund të kenë qenë ministra qeverie, por si anëtarë të Komisionit ata obligohen të veprojnë në interes të Bashkimit Evropian dhe jo të pranojnë instruksione dhe urdhëra nga qeveritë nacionale.

Çdo pesë vjet zgjidhet Komisioni i ri, brenda gjastë muajsh pas zgjedhjeve për Parlamentin Evropian. Procedura është siç vijon:

- Qeveritë e shteteve-anëtare pajtohen së bashku për atë se kush të jetë Kryetar i ri i Komisionit;
- Kryetari i emëruar i Komisionit miratohet pastaj nga Parlamenti;
- Kryetari i emëruar i Komisionit, në biseda me qeveritë e shteteve-anëtare zgjedh

anëtarët tjerë të Komisionit;

- Pastaj Parlamenti i ri interviston të gjithë njëzet anëtarët e rij dhe jep mendimin e vet për gjithë “kolegiumin”. Nëse miratohen propozimet, Komisioni i ri mund zyrtarisht të fillojë punën.

Mandati i tashëm i Komisionit zgjat deri më 31 tetor 2009. Kryetar i Komisionit është José Manuel Barroso.

Komisioni politikisht i jep logari Parlamentit, që ka fuqinë ta shpërndajë atë duke miratuar mocion dënimi. Anëtarët individualë të Komisionit duhet të japin dorëheqje nëse kërkohet nga ata nga Kryetari dhe miratohet nga komisionerët tjerë.

Komisioni përfaqësohet në të gjitha seancat e Parlamentit, ku duhet të sqarojë dhe arsyetojë politikën e tij. Poashtu i përgjigjet në mënyrë të rregullt, pyetjeve me shkrim dhe verbale të APE.

Punën e përditshme të Komisionit e realizojnë zyrtarë administrativë të tij, ekspertë, përkthyes dhe personel sekretarial. Ka rreth 23.000 nëpunës të këtyre Evropianë. Kjo mund të duket shumë, por në fakt është më pak se numri i të punësuarve në shumicën e këshillave të qyteteve në Evropë.

Ku gjendet Komisioni?

“Selia” e Komisionit është në Bruksel (Belgjikë), por poashtu ka zryra në Luksemburg,



Për secilin shtet të BE-së ekziston një komisioner.

përfaqësi në të gjitha shtetet e BE-së dhe delegacione në shumë qytete botërore.

Çfarë bën Komisioni?

Komisioni Evropian ka katër role kryesore:

1. T’i propozojë ligje Parlamentit dhe Këshillit;
2. Të menaxhojë dhe implementojë politikën dhe buxhetin e BE-së;
3. Të zbatojë ligjin evropian (së bashku me Gjykatën e Drejtësisë);
4. Të përfaqësojë Bashkimin Evropian në skenën ndërkombëtare, për shembull duke negociuar marrëveshje me BE-së dhe shteteve tjera.

1. Propozimi i legjislacionit të ri

Komisioni ka “të drejtën e iniciativës”. Me fjalë tjera, Komisioni është përgjegjës për të përpiluar propozime për legjislacion të ri evropian, që i prezantohet Parlamentit dhe Këshillit. Këto propozime duhet t’i mbrojnë interesat e Bashkimit Evropian dhe qytetarëve të tij, por jo interesat e vendeve apo industrive të caktuara.

Para se të japë ndonjë propozim, Komisioni duhet të jetë i vetëdijshëm për situatat dhe problemet e reja në Evropë dhe duhet të marrë parasysh se a është legjislacioni Evropian mënyra më e mirë për t’u ballafaquar me to.

Mu për këtë shkak Komisioni është në kontakt të vazhdueshëm me grupe të ndryshme interesi dhe dy organe këshillëdhënëse – Komiteti Ekonomik dhe Social dhe Komiteti i Rajoneve. Komisioni poashtu kërkon mendim nga parlamentet dhe qeveritë nacionale.

Komisioni do të propozojë veprim në nivel të BE-së vetëm nëse mendon se problemi nuk mund të zgjidhet në mënyrë më efektive në nivel nacional, rajonal apo lokal. Ky parim i balancimit me qështje të ndryshme në nivelin më të ulët quhet edhe “parimi i subsidiaritetit”.

Mirëpo, nëse Komisioni konkludon se nevojitet legjislacioni i ri i BE-së, atëherë ai harton një propozim që beson se do t’i përgjigjet problemit në mënyrë më efektive dhe që do të kënaqë numrin më të madh të interesave. Për t’i pasur detajet e sakta teknike, Komisioni konsulton ekspertë që përbëjnë komitetet dhe grupet e tij të ndryshme pune. Shpesh, Komisioni publikon dokument të ‘Gjelbër’ dhe të ‘Bardhë’, mban dëgjime, kërkon qëndrime nga shoqëria civile dhe bën raporte të specializuara apo ekspertiza, dhe shpesh konsulton drejtpërdrejtë publikun para se ta bëjë një propozim në mënyrë që të sigurohet që e ka kompletuar fotografinë.

2. Implementimi i politikave dhe buxhetit të BE-së

Si organ ekzekutiv i Bashkimit Evropian, Komisioni është përgjegjës për menaxhimin dhe implementimin e buxhetit të BE-së. Shumë nga shpenzimet aktuale bëhet nga autoritetet nacionale dhe lokale por Komisioni është përgjegjës për mbikëqyrje- nën syrin e Gjykatës së Auditorëve. Të dy institucionet mëtojnë të arrijnë një menaxhim të mirë financiar. Vetëm kur të jepet pëlqimi nga Gjykata e Auditorëve për raportin vjetor, tek atëherë Parlamenti Evropian e shkakton Komisionin për implementimin e buxhetit.

Komisioni poashtu duhet të implementojë



BE financon avancimin e infrastrukturës së telekomunikacionit në rajonet më pak të zhvilluara të BE-së.

vendimet e ndërmarra nga Parlamenti dhe Këshilli, sikur janë ato që lidhen me politikën e përbashkët bujqësore, peshkimin, energjinë, zhvillimin rajonal, mjedisin, rininë dhe skemat e trajnimit edukativ dhe shkëmbimit, sikur është programi Erasmus. Poashtu luan rol në politikën e konkurrencës në mënyrë që të sigurojë se bizneset operojnë në kushte të njëjta dhe konkurrencte. Komisioni mund t’i ndalojë shkrirjet në mes të kompanive nëse mendojnë që ato do të shpijnë deri te konkurrenca jo lojale. Komisioni poashtu duhet të sigurojë mos shkeljen e konkurrencës nga vendet e BE-së nëpërmes tejkalimit të subvencioneve për industrinë e tyre.

3. Zbatimi i ligjit Evropian

Komisioni vepron si "roje e Traktateve". Kjo domethënë se Komisioni, së bashku me Gjykatën e Drejtësisë, është përgjegjës për të siguruar se ligji evropian zbatohet ashtu siç duhet në të gjitha shtetet-anëtare.

Nëse vërtetohet se ndonjë shtet i BE-së nuk zbaton një ligj evropian dhe në këtë mënyrë nuk i plotëson obligimet e veta ligjore, Komisioni fillon të ashtuquajturën 'procedura e shkëlqes'. Hapi i parë konsiston në dërgimin e një letre zyrtare qeverisë, duke thënë se pse Komisioni e konsideron këtë vend shkelës të ligjit Evropian dhe e përçakat afatin kohor për dërgimin e sërimit të detajuar.

Nëse shteti anëtarë nuk ka sqarim të kënaqshëm apo dëshiton në sqarimin e çështjeve, Komisioni do dërgon edhe një letër me të cilën konfirmim se është shkellur ligji i BE-së dhe përcakton afatin kohor që e njëjta të rregullohet. Nëse shteti anëtarë nuk bindet, Komisioni e dërgon çështjen tek Gjykata e Drejtësisë për vendosje. Vendimet e Gjykatës janë të detyrueshme për shtetet anëtare dhe institucionet e BE-së. Në rastet ku shtetet anëtare dështojnë në përkrahjen e një vendimi, Gjykata mund të shqiptojë sanksione financiare.

4. Përfaqësimi i BE-së në skenën ndërkombëtare

Komisioni Evropian është zëdhënës dhe avokat i rëndësishëm i Bashkimit Evropian në skenën ndërkombëtare. Është zëri i BE-së në forumet ndërkombëtare. Është një nga organizatat Tregtare Botërore, negociatat për marrëveshjen ndërkombëtare për ndryshimet klimatike, Protokolli i Kiotos, ndihmën e rëndësishme të BE-së dhe partneritetin tregtar me shtetet në zhvillim të Afrikës, Karabeve dhe Pacifikut, të njohur si Marrëveshja e Kotonusit.

Komisioni poashtu ka përgjegjësi për të n-
gocuar marrëveshje ndërkombëtare në emër

të BE në fushat ku shtetet anëtare e kanë bashkuar sovranitetin. Kjo bëhet mbi bazën e marrëveshjeve të arritura paraprakisht me shtetet.

Si është e organizuar puna e Komisionit?

Nga Kryetari i Komisionit varet se cili komisioner do të jetë përgjegjës për lëmi të caktuara dhe a duhet që këto përgjegjësi t'i jepen tieterkult qatë mandatit të Komisionit.

Komisioni përgjithësisht takohet një herë në javë, zakonisht të mërkurave në Bruksel. Çdo pikë në agjendë prezantohet nga komisioneri përgjegjës për lëmi të caktuar dhe Kolegjiumi merr vendim kolektiv për atë.

Personeli i Komisionit është i organizuar në departamente, të njohura si "Drejtoratë të Përgjithshme" (DP) dhe në "shërbime" (sic është Shërbimi Ligjor). Çdo drejtoratë është përgjegjës për sfera të caktuara dhe udhëhiqet nga drejtor-gjeneral, që i jep llogari njërit nga komisionerëve. Koordinimi i përgjithshëm bëhet nga Sekretariati Gjeneral, i cili poashtu menaxhon takimet javore të Komisionit. Udhëhiqet nga Sekretari Gjeneral, i cili i jep llogari drejtoreshit të Kravatit.

Drejtoratet në fakt hartojnë propozimet legjislativë të Komisionit, por këto propozime bëhen zyrtare vetëm kur miratohen nga Kolegjiumi në mbledhjet e tij javore. Procedura është përafërsisht, siç vijon.

Të supozojmë se Komisioni, për shembull, shih nevojë për legjislacion të ri të BE-së për parandalim të ndotjes së lumenjve të Evropës. Drejtori-Gjeneral për Mjedisin do të përgatisë një propozim, të bazuar në konsultimet me industrinë dhe fermerët evropianë, me ministritë e mjedisit në shtetet-anëtare të BE-së. Pas kësaj legjislacioni i propozuar do të diskutohet me të gjitha departamentet relevante të Komisionit dhe do të kontrollohet nga Shërbimi Ligjor dhe nga Sekretariati Gjeneral.



Presidenti i Komisionit Evropian Jose Manuel Barroso i vrojton pasojat dramatike të ndryshimit klimatik në Greqinë

Pasi që propozimi të jetë gati, Sekretari-Gjeneral do ta përfshijë në agjendën për mbledhjen e ardhshme të Komisionit. Nëse 14 nga 27 komisionerë e miratojnë propozimin, Komisioni do ta miratojë atë dhe do ta ketë mbështetjen e pakursyer të krejt ekipit. Dokumenti pastaj do t'i dërgohet Këshillit dhe Parlamentit për të vendosur për propozimin. Komisioni pastaj mund të bëjë ndryshime nën dritën e

komenteve të bëra nga këto dy institucione dhe pastaj ta kthej të njëjtin për miratimin përfundimtar.



Gjykata e Drejtësisë: mbështetje ligjit

FAKTET KYÇE

ROLI //	Të sjellë vendime gjyqësore për rastet që paraqiten para Gjykatës
GJYKATA E DREJTËSISË //	Një gjykatë nga çdo vend i BE-së; tetë avokatë të përgjithshëm
GJYKATA E INSTANCËS SË PARË //	Së paku një gjykatë nga çdo shtet i BE-së (27 në 2007)
TRIBUNALI SHËRBIMIT CIVIL //	Shtatë gjykatë
MANDATI //	Gjashhtë vjet me mundësi rizgjedhjeje
ADRESA //	Boulevard Konrad Adenauer, L-2925 Luksemburg
TELEFONI //	(352) 43 03-1
INTERNET FAQJA //	curia.europa.eu

Gjykata e Drejtësisë së Komuniteteve Evropiane (të cilës shpesh i referohen thjeshtë si 'Gjykata') daton që nga Traktatet e para, pra Traktati Evropian për Thëngjill dhe Çelik i vitit 1952. Është e vendosur në Luksemburg.

Detvra e tij është të sigurojë se legjislati i BE-së interpretohet dhe zbatohet në mënyrë të njëjtë në çdo shtet-anëtar, në mënyrë që të sigurojë se ligji do të jetë çdoherë identik për të gjitha palët dhe në të gjitha rrethanat. Siguron, për shembull, se gjykatat vendore nuk bëjnë interpretim të ndryshëm mbi çështjet e njëjta.

Gjykata poashtu siguron që shtetet anëtare të BE-së dhe institucionet bëjnë atë që e kërkon ligji. Gjykata ka fuqinë dhe të drejtën që të zgjidh kontestet ligjore mes shteteve-anëtare, institucioneve, bizneseve dhe individëve të BE-së.

Gjykata përbëhet nga një gjykatës prej çdo shteti-anëtar, ashtu që të gjitha 27 sistemet juridike nacionale janë të përfaqësuara. Për shkak të efikasitetit, megjithatë Gjykata trallë

ulet në përbërjen e plotë. Pasi që zakonisht ulet në 'Dhomën e Madhe' prej vetëm 13 gjykatëve apo në dhoma të përbërë nga pesë apo tre gjykatë.

Gjykata asistohet nga tetë "avokatë-gjeneralë". Roli i tyre është të prezantojnë opinione të arsyeshme për rastet që i shqyrton Gjykata. Ata duhet ta bëjnë këtë publikisht dhe në mënyrë të paanshme.

Gjykatësit dhe avokatët-gjeneralë janë ose anëtarë të mëparshëm të gjykatave më të larta nacionale ose avokatë shumë kompetentë, të cilëve mund t'u besohet për paanshmërinë dhe objektivitetin e tyre. Ata janë të emëruar me vendim të përbashkët të qeverive të shteteve-anëtare. Çdonjëri emërohet për mandat gjashtëvjeçar, pas së cilit ata mund të rizgjidhen.

Për t'i ndihmuar Gjykatës së Drejtësisë të shqyrtojë rastet e shumta dhe për t'u ofruar qytetarëve mbrojtje më të mirë ligjore, në vitin 1989 u formua Gjykata e Instancës së

Parë. Kjo gjykatë (që është pjesë përbërëse e Gjykatës së Drejtësisë) është përgjegjëse për të sjellë vendime për raste të veçanta, sidomos për rastet e paraqitura nga individë privatë dhe rastet që kanë të bëjnë me konkurrencën jokorrekte mes bizneseve. Kjo gjykatë ka poashtu një gjykatë nga çdo vend i BE-së.

Tribunali Evropian i Shërbimit Civil vendosë kontestet në mes të Bashkimit Evropian dhe shërbimit të tij civil. Tribunali përbëhet nga shtatë gjykatë dhe është i bashkangjitur në Gjykatën e Instancës së Parë.

Gjykata e Drejtësisë, Gjykata e Instancës së Parë dhe Tribunali i Shërbimit Civil kanë kryetarë në vete, të zgjedhur nga kolegët e tyre gjykatës, për të shërbyer mandat trevjeçar me mundësi rizgjedhjeje. Vassilios Skouris është zgjedhur Kryetar i Gjykatës së Drejtësisë më 2003. Marc Jaeger është kryetar aktual i Gjykatës së Instancës së Parë. Paul J. Mahoney është zgjedhur Kryetar i Tribunalit të Shërbimit Civil që prej 2005.

Çfarë bën Gjykata?

Gjykata sjell aktgjykime për rastet që i jepen për shqyrtim. Pesë lojet më të shpeshta të rasteve janë:

1. kërkesat për vendim paraprak;
2. procese gjyqësore për dështim të përm-bushjes së obligimeve;
3. procese gjyqësore për anulim;
4. procese gjyqësore për dështim veprimi, dhe
5. procese gjyqësore për dëme.

Të gjitha janë të përshkruara më detajisht në vijim.

1. Procedura për vendim paraprak

Gjykatat në çdo shtet të BE janë përgjegjëse për të siguruar se ligji i BE-së zbatohet në mënyrë adekuate. Por ekziston rreziku që gjykatat në shtete të ndryshme ta interpretojnë ligjin e BE-së në mënyra të ndryshme.



Stjuardësat kanë përfutur disa herë nga vendimet e Gjykatës Evropiane të Drejtësisë mbi pagesat dhe të drejtat e barabarta.

Gjykata Evropiane e Auditorëve: shpenzim i arsyeshëm i parave tuaja



FAKTET KYÇE

ROLI //	Të kontrollojë se fondet e BE shfrytëzohen në mënyrë adekuate
ANËTARËT //	Nga një anëtar prej çdo shteti anëtar të BE
MANDATI //	Anëtarët emërohen për term gjashtëvjeçar, me mundësi për rizgjedhje
ADRESA //	12 rue Alcide de Gasperi, L-1615 Luksemburg
TELEFONI //	(352) 43 98-1
INTERNET FAOJA //	eca.europa.eu

Që të parandalohet kjo, ekziston "procedura për vendim paraprak". Kjo do të thotë që nëse gjykata nacionale është e pasigurt në interpretimin apo vlefshmërinë e ndonjë ligji të BE-së, ajo mundet, e ndonjëherë edhe duhet, të konsultohet me Gjykatën e Drejtësisë. Kjo këshillë jepet në formë të "vendimit paraprak".

2. Proceset gjyqësore për dështim në përbushjen e detyrimeve

Komisioni mund të iniciojë këto procese gjyqësore nëse ka arsye që të besojë se një shtet-anëtar dështon t'i përbushë obligimet e parapara me ligjin e BE-së. Këto procese poashtu mund të iniciohen nga ndonjë shtet-anëtar.

Në të dyja rastet, Gjykata heton pohimet dhe jep gjykimin e vet. Nëse vërtetohet se është fajtor, shteti-anëtar i akuzuar duhet menjëherë t'i përmirësojë veprimet dhe t'i përbushë detyrimet, përndryshe Gjykata mund t'i shqiptojë sanksione atij vendi.

3. Proceset gjyqësore për anulim

Nëse ndonjëri nga shtetet-anëtare, Këshilli, Komisioni apo (në rrethana të caktuara) Parlamentit mendon se ndonjë ligj i caktuar është i kundërligjshëm, atëherë secila nga këto institucione mund të kërkojë nga Gjykata anulim të atij ligji.

Këto "procese për anulim" mundën poashtu të iniciohen nga individë, të cilët duan që Gjykata të anulojë ndonjë ligj të caktuar sepse në mënyrë të drejtpërdrejtë ndikon në ata individë dhe ka efekt të kundërt.

Nëse Gjykata vërteton se ligji në fjalë nuk ka qenë i miratuar në mënyrë korrekte ose nuk bazohet në mënyrë korrekte në Traktatet Evropiane, mund ta shpallë atë ligj të pavlefshëm.

4. Proceset gjyqësore për dështim veprimi

Traktati parashihet që Parlamenti Evropian, Këshilli

dhe Komisioni të marrin vendime të caktuara nën rrethana të caktuara. Nëse ata dëshojnë ta bëjnë këtë, shtetet-anëtare, institucionet tjera të Bashkimit Evropian dhe (në rrethana të caktuara) individë apo kompani mund të paraqesin ankësë në Gjykatë, për të regjistruar zyrtarisht këtë shkelje.

5. Proceset gjyqësore për dëme

Çdo person apo kompani të cilës i është shkaktuar dëmi si pasojë e një veprimi apo mos-veprimi të Komunitetit apo personelit të tij, mund të paraqes veprimin për kërkim të kompensimit para Gjykatës së Instancës së Parë.

Si është e organizuar puna e Gjykatës?

Rastet së pari regjistrohen dhe pas kësaj emërohet gjykatësi i caktuar dhe avokati gjeneral për secilin rast.

Procedura që pason është dyfazëshe: së pari është faza me shkrim, e pastaj faza orale.

Në fazën e parë, të gjitha palët e përfshira paraqesin deklaratat me shkrim dhe gjykatësi i emëruar në këtë rast përpilon një raport ku përmblledh këto deklaratat dhe të kaluarën ligjore të këtij rasti.

Mandel pason faza e dytë – hetimi publik. Varësisht nga rëndësia dhe kompleksiteti i rastit, kjo seancë mund të dëgjohet para dhomës prej tre, pesë apo 13 gjyqtarë, apo para Gjykatës në përbërje të plotë. Gjatë hetimit, avokatët e palëve paraqesin rastin para gjykatësve dhe para avokatit gjeneral, të cilët mund t'u parashtojnë pyetje avokatëve që përfaqësojnë klientët. Pastaj avokati gjeneral jep konkluzat e tij/saj, pas së cilës gjykatësit shqyrtojnë çështjen dhe shpallin aktgjykimet e tyre. Kjo jo domosdoshmërisht e përfaqësojnë opinionin e avokatit gjeneral.

Vendimet e Gjykatës vendosen nga shumica dhe shpallen në përfundim të hetimit publik. Ndryshimet në përkrahje nuk shprehen. Vendimet publikohen në ditën e tështimit.

Procedura para Gjykatës së Instancës së Parë është e ngjashme, përveç se nuk ka opinion nga avokati gjeneral.

Gjykata e Auditorëve është formuar në vitin 1975. Është e vendosur në Luksemburg. Gjykata e Auditorëve kontrollon të gjitha të hyrat e BE-së dhe atë se të gjitha shpenzimet e tij janë kryer në mënyrë ligjore dhe të rregullt në mënyrë që qytetarët e BE-së të bëjnë shpenzimin e arsyeshëm e parasë. Poashtu ka të drejtë të auditojë çdo person apo organizatë që menaxhon me fondet e BE-së.

Gjykata ka nga një anëtar prej çdo shteti të BE-së, që emërohet nga Këshilli për mandat gjashtëvjeçar, me mundësi për rizgjedhje. Anëtarët e zgjidhin një nga ta si Kryetar të Gjykatës me mandat prej tri vitesh me mundësi rizgjedhjeje. Hubert Weber ka qenë Kryetar i Gjykatës së Auditorëve që nga janari 2005.

Çfarë bën gjykata?

Roli kryesor i Gjykatës është të kontrollojë se buxheti i BE-së është implementuar në mënyrë korrekte, me fjalë tjera, të sigurojë se të ardhurat dhe shpenzimet e BE-së

janë ligjore dhe të ndershme, si dhe të sigurojnë menaxhimin korrekta financiar. Puna e kësaj gjykate ndihmon të garantojë se sistemi i BE-së operon në mënyrë efektive dhe transparente.

Për të kryer detyrën që ka, Gjykata heton dokumentacionin e secilës organizatë të BE-së që ka të hyra apo shpenzime. Po të ketë nevojë, Gjykata kryen kontrolle në vendin e ngjarjes, pra brenda në organizatë. Informatat e siguruar shikohen në raporte, që i tërheqin vëmendjen Komisionit dhe shteteve anëtare për problemet eventuale.

Për ta kryer punën e vet sa më mirë, Gjykata e Auditorëve duhet të jetë e pavarur nga institucionet tjera, por njëkohësisht të jetë në kontakt të vazhdueshëm me ato.

Një nga detyrat e saj kyçe është t'u ndihmojë Parlamentit Evropian dhe Këshillit, duke ua prezantuar atyre çdo vit një raport për vitin e kaluar financiar. Komentet që i bën në

këtë raport vjetor luajnë rol të rëndësishëm që Parlamenti të sjellë vendim se Komisioni mund të menaxhojë me buxhetin. Nëse janë të kënaqur, Gjykata e Auditorëve poashtu u dërgon Këshillit dhe Parlamentit deklarata vërtetuese se paratë e taksa-paguesve evropiane janë shfrytëzuar në mënyrë adekuate.

Përfundimisht, gjykata i informon qytetarët lidhur me rezultatet e punës së saj nëpërmes raporteve mbi çështjet me interes të veçantë.

Si është e organizuar puna e gjykatës?

Gjykata ka përafërsisht 800 të punësuar të kualifikuar, përfshirë përthyesit dhe auditorët. Auditorët janë të ndarë në 'grupe të auditimit'. Ata përgatisin draft raporte për të cilat gjykata merr vendime.

Auditorët shpesh inspektojnë institucionet tjera të BE-së, shtetet-anëtare dhe shtetet që pranojnë ndihma nga BE. Vërtetë, edhe pse puna e Gjykatës ka të bëjë me paratë për të cilat është përgjegjës Komisioni, 80% e këtyre të hyrave dhe shpenzimeve menaxhohen nga autoritetet nacionale.

Gjykata e Auditorëve nuk ka forcë zbatuese ligjore. Nëse auditorët zbulojnë manipulim ose parregullsi, ata e përcjellin informata sa më shpejtë që mundet te ZEKM – Zyra Evropiane Kundër Mashtrimit. ZEKM është departament i Komisionit Evropian me status të posaçëm që i siguron autonomi totale.



© Van Parys Media

Shenjat e veshëve të vendosura te lopët u ndihmojnë auditorëve të BE-së të mbajnë kontroll mbi atë se ku janë shpenzuar paratë e BE-së.



Komiteti Evropian Ekonomik dhe Social: zëri i shoqërisë civile

FAKTET KYÇE

ROLI //	Përfaqëson shoqërinë civile të organizuar
ANËTARËT //	344
MANDATI I ZYRËS //	Katër vite
TAKIMET //	Bruksel, muajore
ADRESA //	Rue Belliard 99, B-1040 Bruksel
TELEFONI //	(32-2) 546 90 11
INTERNET FAQJA //	eesc.europa.eu

I themeluar në 1957 me Traktatin e Romës, Komiteti Evropian Ekonomik dhe Social (KEES) i ka 344 anëtarë. Numri i secilit shtet të BE-së paraqet pak a shumë madhësinë e popullsisë së saj. Numrat për vend janë si vijon:

Francë,	Gjermani,	Itali	dhe	Mbretëria e Bashkuar	24
Poloni dhe Spanjë					21
Rumani					15
Austri, Belgjikë, Bullgari, Republika Çeke, Greqi, Hungari, Holandë, Portugali dhe Suedi					12
Danimarkë, Finlandë, Irlandë, Lituanë dhe Sllovakë					9
Estoni, Letoni dhe Slloveni					7
Cipro dhe Luksemburg					6
Malta					5
Gjithsej					344

KEES është një organ këshillëdhënës që i ofron përfaqësuesve të grupeve të interesit të BE-së, sic janë punëdhënësit, sindikatat, dhe grupet tjera të interesit, që paraqesin "shoqërinë e organizuar civile", si shoqatat e konsumatorëve, platformë për të shprehur këndvështrimet për çështjet e BE-së.

Anëtarët emërohen nga qeveritë e BE-së por ata punojnë në pavarësi të plotë politike. Ata emërohen për katër vite, dhe mund të riemërohen.

Komiteti takohet në asamble plenare dhe diskutimet e tij përgatiten nga gjashtë nën-komitete, të njohura si "departamente", secili mbulon lëmi të caktuar. Komiteti zgjedh kryetarin dhe dy nënkryetarë për mandat dyvjeçar. Dimitris Dimitriadis është bërë Kryetar i KEES në tetor 2006.

Cfarë bën KEES?

Komiteti Evropian Ekonomik dhe Social ka tri role:

- të këshillojë Parlamentin Evropian, Këshillin, Bashkimin Evropian dhe Komisionin Evropian, ose me kërkesë të tyre ose me vetiniciativë të Komitetit;
- të inkurajojë shoqërinë civile që të përfshihet më shumë në procesin e vendimmarrjes të BE-së;
- të mbështesë dhe nxisë rolin e shoqërisë civile në shtetet që nuk janë anëtarë të BE dhe të ndihmojë për të formuar strukturë këshillëdhënëse.

Opinionet e Komitetit i drejtohen institucioneve më të mëdha — Këshillit, Komisionit dhe Parlamentit Evropian. Duhet të konsultohet para se të merren vendimet që lidhen me politikën ekonomike dhe social, rajonale dhe mjedisore. Prandaj ka rol kryesor në procesin e vendim-marrjes në Bashkimin Evropian. KEES është urë në mes të Bashkimit Evropian dhe qytetarëve të saj, që promovon shoqëri më plesëmarrëse, më përfshirëse dhe më

demokratike në Evropë.

Kush janë anëtarë të KEES?

Kryesisht duke punuar në shtetet e tyre, anëtarët e Komitetit formojnë tre grupe që i përfaqësojnë punëdhënësit, të punësuarit dhe interesat e ndryshme ekonomike dhe sociale.

Grupi i Punëdhënëseve ka anëtarë prej sektorit privat e publik të industrisë, bizneseve të vogla e të mesme, odave ekonomike, tregtisë me shumicë dhe pakicë, bankave dhe sigurimeve, transportit dhe bujqësisë.

Grupi i të Punësuarve përfaqëson të gjitha kategoritë e të punësuarve, nga punëtorët fizikë deri te ata ekzekutivë. Anëtarët e këtij grupi vijnë nga organizatat sindikaliste nacionale.

Grupi i tretë përfaqëson Grup të Interesave të Ndryshme: OJQ, asociacionet e fermerëve, bizneset e vogla, zanatet dhe profesionet, kooperativat dhe asociacionet jo-profitabile, organizatat e konsumatorëve dhe ato të mjedisit, shoqatat shkencore dhe akademike, si dhe asociacionet që përfaqësojnë familjen, gratë, personat e hendikepuar, etj.



Organizatat që përfaqësojnë interesat e familjeve janë në mesin e grupeve zëri i të cilëve shprehet përmes KEES.



Komiteti i Rajoneve: zëri i qeverisë rajonale dhe lokale

FAKTET KYÇE

ROLI //	Përfaqëson autoritetet rajonale dhe lokale
ANËTARËT //	344
MANDATI //	Katër vite
MBLEDHJA //	Në Bruksel, pesë mbledhje plenare në vjet.
ADRESA //	Rue Belliard 101, B-1040 Bruksel
TELEFONI //	(32-2) 282 22 11
INTERNET FAQJA //	cor.europa.eu

Komiteti i Rajoneve, i formuar në vitin 1994 me Traktatin e Bashkimit Evropian, ka 344 anëtarë. Numri prej çdo vendi anëtarë përfshishtë pasqyron madhësinë e popullsisë, më sa vijon:

Francë, Gjermani, Itali dhe Mbetëri e Bashkuar	24
Poloni dhe Spanjë	21
Rumani	15
Austri, Belgjikë, Bullgari, Republika Çeke, Greqi, Hungari, Holandë, Portugali dhe Suedi	12
Danimarkë, Irlandë, Lituan, Sllovaki dhe Finlandë	9
Estoni, Letoni dhe Slloveni	7
Qipro dhe Luksemburg	6
Malta	5
Gjithsej	344

Komiteti është një organ këshillëdhënës i përbërë nga përfaqësues të autoriteteve rajonale dhe lokale evropiane. Komiteti i Rajoneve duhet të konsultohet para se të merren vendimet të BE-së në lidhje me politikën rajonale, mjedisore, kulturore, edukative dhe të transportit — të gjitha ato që kanë të bëjnë me qeverinë lokale dhe rajonale.

Anëtarët e Komisionit janë anëtarë të zgjedhur, apo akterë të rëndësishëm, në institucionet komunale apo rajonale, në rajonin e tyre. Ata nominohen në Komitet nga qeveritë nacionale dhe emërohen nga Këshilli i Bashkimit Evropian për katër vite. Ata mund të rizgjidhen. Çdo vendi zgjidhë anëtarë të saj në mënyrën e vet, por përzjerja duhet të pasqyrojë balancën politike dhe gjeografike. Nëse ata e humbin mandatin elektoral në vendin e vetë, duhet të largohen nga Komiteti.

Ekzistojnë katër grupe politike: Partia Popullore Evropiane, Partia e Socialistëve Evropianë, Aleanca e Liberalëve dhe Demokratëve

të Evropës, dhe Bashkimi për Evropën e Kombeve – Aleanca Evropiane.

Komiteti i Rajoneve zgjedh Kryetar nga anëtarët e tij, me mandat dyvjeçar. Michel Delebarre ishte zgjidhur kryetar në 2006.

Çfarë bën Komiteti?

Roli i Komitetit të Rajoneve është që mendimet dhe propozimet lokale e rajonale t'i inkudrojnë në legjislacionin e BE-së. Këtë e bën duke shprehur 'mendime' lidhur me propozimet e Komisionit.

Komisioni dhe Këshilli duhet ta konsultojnë Komitetin e Rajoneve për çështjet me relevancë për autoritetet lokale dhe rajonale. Këto mund të jenë politikat e punësimit, edukimit, kulturës, trajnimit profesional dhe rinisë, energjisë, transportit, telekomunikimit, dhe shëndetit publik.

Lista nuk është përfundimtare. Komisioni, Këshilli dhe Parlamenti Evropian janë të lirë të konsultojnë Komitetin për çështjet tjera. Për pjesën e vet, komiteti mund të miratojë mendime të iniciuara nga vet Komiteti dhe t'ia prezantojë ato Komisionit, Këshillit dhe Parlamentit.

Si është e organizuar puna e Komitetit?

Çdo vjet Komiteti i Rajoneve mban pesë mbledhje plenare, gjatë së cilave definojnë politikat e përgjithshme dhe miratojnë propozimet.

Ka gjashtë komisione që trajtojnë politika të ndryshme dhe përgatisin mendime që do të debatohen në seancat plenare.



Çasia në trajnim vokacional dhe mësim gjatë tërë jetës në Evropë është me rëndësi parësore për Komitetin e Rajoneve.

Banka Evropiane e Investimeve: financimi i zhvillimit ekonomik



FAKTET KYÇE

ROLI //	Financon zhvillimin ekonomik
ANËTARËT //	Shtetet anëtare të BE-së Bordi i Drejtorëve 28, Komiteti Menaxhues 9.
ADRESA //	100, Boulevard Konrad Adenauer, L-2950 Luksemburg
TELEFONI //	(352) 43 79-1
INTERNET FAQJA //	www.eib.org

Banka Evropiane e Investimeve (BEI) u formua në vitin 1958 me Traktatin e Romës. Roli i saj kryesor është të huazojë para për projekte të interesit Evropian, sikur janë lidhjet hekurudhore dhe rrugore, aeroportet, apo skemat mjedisore. Poashtu ofron financim për bizneset e vogla në BE dhe për zhvillimin ekonomik në vendet candidate dhe vendet e botës në zhvillim.

Philippe Maystadt u bë Kryetar i EIB në janar 2000.

Çfarë bën Banka?

BEI është institucion jo-profitabil, i vetë mbajtur financiarisht, i pavarur nga buxheti i BE-së. Financohet me hua nga tregjet financiare. Aksionarët e bankës – shtetet anëtare të Bashkimit Evropian – bashkërisht marrin pjesë në kapitalin e bankës; kontributi i çdo shteti reflekton pjesëmarrjen ekonomike në Bashkim Evropian.

Kjo mbështetjet nga shtetet-anëtare i jep

Bankës Evropiane të Investimeve rangimin më të lartë të mundshëm për kreditim (AAA) në tregjet e parave, ku rrjedhimisht mund të tërhiqen shuma të mëdha të kapitalit me kushte shumë konkurruese. Kjo i mundëson bankës të investojë në projekte me interes publik, të cilat ndryshe nuk do të mund të përfitonin ose do të duhej t'i huazonin me kushte shumë të pavolitshme.

Projektet në të cilat investon banka zgjidhen me kujdes.

Prioritetet e saj në BE janë që të mbështesin:

Its priorities in the EU are to support:

- kohezionin dhe konvergencën,
- ndërmarrjet e vogla dhe të mesme,
- qëndrueshmërinë mjedisore,
- inovacionin,
- zhvillimin e rrjeteve trans-Evropiane të transportit, dhe

- energjinë e qëndrueshme, konkurrenca dhe të sigurtë.

Jashtë BE-së, BEI poashtu përkrah politikën zhvillimore dhe të bashkëpunimit të BE-së në vendet candidate dhe ato potenciale kandidate, shtetet e Mesdheut dhe Evropës lindore (përfshirë Rusinë) të cilat mbulohen me politikën e fqinjësisë së BE-së, dhe shtetet e Afrikës, Karalibeve dhe Pacifikut dhe Amerikës Latine. Huazimi në këto vende fokusohet në:

- zhvillimin e sektorit privat,
- zhvillimin e infrastrukturës,
- sigurimit të furnizimit me energji, dhe
- qëndrueshmërisë mjedisore.

Së fundi, BEI është aksionare më e madhe në Fondin Evropian të Investimeve, me të cilin përbëjnë 'EIB Grup'. Fondi investon në kapitale të përbashkëta dhe ofron garancione për ndërmarrje të vogla dhe të mesme. Nuk jep hua drejtpërdrejtë bizneseve apo firmave. Në vend të kësaj, punon nëpërmes bankave dhe ndërmjetësuesve tjerë financiar, duke ofruar garancione për mbullimin e kredive të tyre për bizneset e vogla.

Fondi është aktiv në shtetet anëtare të Bashkimit Evropian dhe në shtetet që janë candidate për anëtarësim.

Si është e organizuar puna e Bankës?

BEI është institucion autonom. Vendimet e veta mbi huamarrjen dhe huadhënien i bën vet në meritat e çdo projekti dhe mundësisë së ofruar nga tregu financiar. Çdo vit, paraqet raport për të gjitha aktivitetet.

Banka bashkëpunon me institucionet e BE-së. Për shembull, përfaqësuesit e saj mund të marrin pjesë në komitete të Parlamentit Evropian, e Drejtori i BEI mund të marrë pjesë në mbledhjet e Këshillit kur takohen ministrat e Ekonomisë dhe Financave të shteteve të

BE-së.

Vendimet e bankës i sjellin organet në vazhdim:

- Bordi i Guvernatorëve përbëhet nga ministrat (zakonisht ministrat e financave) prej të gjitha shteteve anëtare. Ky bord definon politikën e përgjithshme të Bankës për huazime, aprovon bilancin dhe raportin vjetor, autorizon Bankën të financojë projekte jashtë BE-së dhe vendos për rritjen e kapitalit.
- Bordi i Drejtorëve aprovon operacionet huazuese, si dhe siguron menaxhimin adekuat të BEI-së, përbëhet nga 28 anëtarë të emëruar nga shtetet anëtare dhe një nga Komisioni Evropian.
- Komiteti Menaxhues është organ plotësisht ekzekutiv i kësaj banke. Menaxhon aktivitetet e përditshme të BEI-së. Ka nëntë anëtarë.



Banka Evropiane e Investimeve i ka huazuar para Republikës Çeke për mbrojtje më të mirë nga vërshimet

Banka Qendrore Evropiane: menaxhimi me euron



FAKTET KYÇE

ROLI //	Të mbajë stabilitetin e çmimit në zonën e euros dhe të bëjë politika monetare
ANËTARËT //	Këshilli Drejtues – 19, Këshilli i Përgjithshëm – 29, Bordi Ekzekutiv – 6
ADRESA //	Kaiserstrasse 29, D-60311 Frankfurt am Main
TELEFONI //	(49) 691 34 40
INTERNET FAQJA //	www.ecb.eu

Banka Qendrore Evropiane (BQE) u formua në vitin 1998. Është e vendosur në Frankfurt (Gjermani). Puna e saj është për të menaxhuar euron — monedhën e vetme të BE-së, dhe për të siguruar stabilitetin e çmimit për më shumë se dy-të-tretat e qytetarëve të BE-së të cilët e përdorin euron. BQE është poashtu përgjegjëse për strukturimin dhe implementimin e politikës monetare të zonës së euros.

Për ta realizuar detyrën e vet, BQE punon me Sistemin Evropian të Bankave Qendrore (SEBQ). Vendet që deri më tani kanë adoptuar euron, kolektivisht e bëjnë 'zonën e euros'. Bankat qendrore të këtyre vendeve, së bashku me Bankën Qendrore Evropiane, paraqesin atë që njihet si "Euro-sistemi".

BQE punon në pavarësi të plotë. As BQE, bankat qendrore nacionale të Eurosistemit, e as ndonjë anëtar i organeve të tyre vendimmarrëse, nuk mund të kërkojë ose të pranojë instruksione nga ndonjë organ tjetër.

Institucionet e BE-së dhe qeveritë e shteteve anëtare duhet të respektojnë këtë parim dhe nuk duhet të përpiqen të ndikojnë mbi BQE-në ose mbi bankat qendrore nacionale.

Jean-Claude Trichet u bë kryetar i BQE-së në nëntor 2003.

Çfarë bën Banka?

Një nga detyrat kryesore të BQE-së është të kujdeset për stabilitetin e çmimeve në euro hapësirën, duke ruajtur kështu fuqinë blerëse të euros. BQE mëton të sigurojë se rritja vit-pas-viti në çmimet e konsumatorit të jetë më e ultë se, por afër, 2% në periudhë afat-mesme.

BQE e bën këtë duke vendosur standarde të kamatës të bazuar në analizën e zhvillimeve ekonomike dhe monetare. I rrit kamatat nëse dëshiron të frenojë inflacionin, dhe i ulë ato nëse mendon se rreziku i inflacionit është i kufizuar.


Si është e organizuar puna e Bankës?

Bordi Ekzekutiv i BQE-së është përgjegjës për implementimin e politikës monetare, sikur është definuar nga Këshilli Drejtues (shih më poshtë), dhe për ofrimin e instruksioneve bankave qendrore nacionale. Poashtu përgatit takimet e Këshillit Drejtues dhe është përgjegjës për menaxhimin e përditshëm të BQE-së.

BOE përbëhet nga Drejtori i BQE-së, Zëvendës Drejtori dhe nga katër anëtarë tjerë, të gjithë të emëruar me pajtim të kryetarëve apo kryeministrit të shteteve anëtare të euro hapësirës. Anëtarët e Bordit Ekzekutiv janë të emëruar për një mandat tetëvjeçar, pa mundësi për rizgjedhje.

Këshilli Drejtues është organi më i lartë vendimmarrës i Bankës Qendrore Evropiane. Përbëhet nga gjashtë anëtarë e Bordit Ekzekutiv dhe nga guvernatorët e bankave qendrore të euro hapësirës. Kryesohet nga Drejtori i BQE-së. Misioni i tij primar është të definojë politikën monetare të euro hapësirës dhe, në veçanti, të përcaktojë shkallët fikse të interesit (kamatave), të cilat bankat komerciale duhet t'i kenë parasysh kur marrin të holla nga BQE-ja.

Këshilli i Përgjithshëm përbëhet nga Drejtori dhe Zëvendës Drejtori i BQE-së dhe guvernatorët e të gjitha 27 shteteve anëtare të BE-së. Këshilli i Përgjithshëm kontribuon në aspektin këshillues dhe koordinues të BQE-së, si dhe ndihmon në përgatitjen e zgjerimit të ardhshëm të euro hapësirës.



Shtetet e BE-së të cilat e përdorin Euro-n nga janari 2008: Austria, Belgjika, Cipri, Finlanda, Franca, Gjermania, Greqia, Irlanda, Italia, Luksemburgu, Malta, Holanda, Portugalia, Slovenia, dhe Spanja. Shtetet e BE-së të cilat nuk e përdorin Euro-n: Bullgaria, Republika Çeke, Danimarka, Estonia, Hungaria, Letonia, Lituania, Polonia, Rumania, Sllovakia, Suedia dhe Mbretëria e Bashkuar.



Ombudsmani Evropian: hetimi i ankesave tuaja

FAKTET KYÇE

ROLI //	Të zbulojë rastet e keqadministrimit dhe të propozojë zgjidhje
MANDATI //	Pese vite, me mundësi rizgjedhjeje
ADRESA //	1, Avenue du Président Robert Schuman, B.P. 403
TELEFONI //	F-67001 Strasbourg (33) 388 17 23 13
INTERNET FAQJA //	ombudsman.europa.eu

Funksioni i Ombudsmanit Evropian u formua me Traktatin e Bashkimit Evropian (Mastriht, 1992). Ombudsmani vepron si ndërmjetësues mes qytetarëve dhe autoriteteve të BE-së. Ai ka të drejtën t'i pranojë dhe t'i shqyrtojë ankesat e qytetarëve, bizneseve dhe institucioneve të BE-së, si dhe nga ata që banojnë ose që legalisht qëndrojnë në ndonjë shtet të BE-së.

Ombudsmani zgjedhet nga Parlamenti Evropian me mandat pesëvjeçar, me mundësi për t'u zgjedhur përsëri, që korrespondon me mandatin legjislativ të Parlamentit. Nikiforos Diamandouros e ka marrë pozitën e Ombudsmanit Evropian në prill të vitit 2003 dhe është rizgjedhur në janar të 2005 për pesë vite.

Cfarë bën Ombudsmani?

Ombudsmani ndihmon të zbulojë "keqadministrimin" në institucionet e Bashkimit Evropian dhe në organet tjera të BE-së. "Keqadministrim" do të thotë administrim i dobët ose i

dështuar - me fjalë tjera, keqadministrim kemi kur ndonjë institucion i BE-së dështon të bëjë diçka që është dashur ta bëjë ose nëse e bën këtë në mënyrë të gabuar, apo nëse bën diçka që nuk është dashur ta bëjë, apo dështon në respektimin e parimeve të administrimit të mirë, apo shkelë të drejtat e njeriut. Shembuj të keqadministrimit janë:

- jo-korrektësia,
- diskriminimi,
- keqpërdorimi i pozitës,
- mungesa e informatave ose refuzimi për të informuar,
- vonesat e panevojshme,
- procedurat e gabuara.

Ombudsmani bën hetime pas ndonjë anekse apo pas vetë iniciativës së tij. Ai operon tërësisht i pavarur dhe në mënyrë të paanshme. Ai nuk kërkon e as nuk pranon instruksione nga ndonjë qeveri apo organizatë.

Si të ankohem te Ombudsmani?

Nëse doni të ankoheni për keqadministrim nga ndonjë institucion apo organ i BE-së, gjëja e parë që duhet të bëni është të kontaktoni atë institucion apo organ nëpërmes kanaleve të zakonshme administrative dhe të provoni ta rregulloni situatën.

Nëse kjo qasje dështon, mund të ankoheni te Ombudsmani Evropian.

Patjetër duhet ta bëni ankesën te Ombudsmani brenda dy vitesh nga dita kur keni kuptuar se ndodh keqadministrim. Ju duhet të deklaroni qartë se kush jeni dhe ndaj kujt ankoheni, dhe për çfarë problemi ankoheni. Ju mund të kërkontë që ankesa të mbetet konfidenciale.

Për udhëzime praktik se si të bëni ankesë, vizitoni faqen e internetit të Ombudsmanit: ombudsman.europa.eu


Çfarë rezultati mund të pres?

Në qoftë se Ombudsmani nuk mund të merret me ankesën tuaj – për shembull, nëse ka qenë më herët temë e ndonjë rasti në gjykatë- ai do të bëjë më të mirën që t'ju këshillojë se cili organ tjetër do mund t'ju ndihmonte.

Për të zgjidhur problemin tuaj, Ombudsmani mund ta informojë institucionin apo organin në fjalë. Nëse problemi nuk është zgjidhur gjatë kërkesës së tij, Ombudsmani do të provojë të gjejë ndonjë zgjidhje miqësore e cila e rregullon çështjen.

Nëse kjo dështon, Ombudsmani mund të bëjë rekomandime për të zgjidhur çështjen. Nëse institucioni në fjalë nuk e pranon rekomandimin, ai mund të bëjë një raport special për Parlamentin Evropian në mënyrë që të ndërmerret veprimi i nevojshëm politik.

Çdo vit, Ombudsmani i dorëzon Parlamentit Evropian raport për të gjitha rastet e shqyrtuara.



© Van Parys Media

Nëse rasti juaj nuk është duke e marrë vëmendjen e duhur, Ombudsmani është aty për të ju ndihmuar.



Mbikëqyrësi Evropian i të Dhënave: mbrojtja e privacisë tuaj

FAKTET KYÇE

ROLI //	Të mbrojtë të dhënat personale të proceduara nga institucionet e BE-së
MANDATI //	Pesë vite, me mundësi rizgjedhjeje
ADRESA //	Rue Wiertz 60, MO 63, B-1047 Bruksel
TELEFONI //	(32-2) 283 19 00
INTERNET FAQJA //	edps.europa.eu

Pozita e Mbikëqyrësit Evropian për Mbrojtjen e të Dhënave (MEMD) është krijuar më 2001. Përgjegjësitë e MEMD janë të sigurojë se institucionet dhe organet e BE-së e respektojnë të drejtën e privacisë gjersa i procesojnë informacionet.

Çfarë bën MEMD?

Kur institucionet dhe organet e BE-së procesojnë të dhëna personale lidhur me një person të identifikueshëm, ata duhet të respektojnë të drejtën e privacisë së atij personi. MEMD siguron se kjo do të ndodhë.

'Procesimi' përfshinë aktivitetet siç janë mbledhja e të dhënave, regjistrimi dhe ruajtja e tyre, marrja e tyre për konsultim, dërgimi dhe vënia e tyre në dispozicion të njerëzve tjerë, dhe poashtu bllokimi i tyre, zhdukja dhe shkatërimi i tyre.

Ekzistojnë rregulla strikte që i qeverisin këto aktivitete. Për shembull, në përgjithësi institucioneve dhe organeve të BE-së nuk u



© Bilderbox

MEMD kontrollon që të mos ketë abuzime të të drejtave personale kur emigrantët ilegale dhe azil-kërkesit i japin shenjat e gishtërrijëve.



Agjencitë

Si mund t'ju ndihmojë MEMD?

Nëse keni arsye të besoni se e drejta juaj e privacisë është shkelur nga ndonjë institucion apo organ i BE-së, ju duhet së pari ta adresoni çështjen me njerëzit përgjegjës për procesimin. Nëse nuk jeni të kënaqur me rezultatin, ju duhet të kontaktoni zyrtarin përkates të të dhënave (emrat mund të gjinden në faqen e internetit të MEMD).

Ju poashtu mund të ankoheni te Mbikëqyrësi i Mbrojtjes së të Dhënave, i cili do të hetojë ankesën e juaj dhe do ju informojë sa më shpejtë për rezultat. Për shembull, MEMD mund të urdhërojë një institucion apo organ të caktuar për të përmirësuar, bllokuar apo zhdukur të dhënat që në mënyrë joligjore janë procesuar.

Nëse nuk pajtoheni me vendimin e tij, ju mund ta dërgoni çështjen para Gjykatës së Drejtësisë.

lejohe të procesojnë të dhëna personale që e demaskojnë origjinën tuaj racore apo etnike, opinionet politike, besimet fetare apo filozofike apo përkatësinë sindikale.

MEMD punon me zyrtarët e mbrojtjes së të dhënave në çdo institucion apo organ të BE-së për të siguruar se janë aplikuar rregullat e privacisë.

MEMD jep këshilla për të gjitha çështjet që lidhen me procesimin e të dhënave personale — edhe në procesimin e bërë nga institucionet dhe organet e BE-së, edhe në propozimet për legjislacionin e ri. Bashkëpunon me autoritetet nacionale përkatëse të vendeve të BE-së, sikur edhe me palët tjera të kësaj fushe.

Në 2004, Peter Johan Hustinx ishte emëruar si Mbikëqyrës në nivel Evropian i Mbrojtjes së të Dhënave.

Agjencitë nuk janë institucione të BE-së: ato janë organe të themeluara me ndonjë legjislacion të veçantë të BE-së për të ndërmarrë një detyrë të caktuar. Jo të gjitha agjencitë e BE-së kanë fjalën 'agjenci' në titullin e tyre zyrtar: ata mund të jenë, për shembull, qendra, fondacione, institute apo zyre.

Agjencia Komunitare për Kontroll të Peshkimit (AKKP)

Vendi: Vigo, Spanjë (selia e përkohshme: Bruksel, Belgjikë),
ec.europa.eu/cfca/index_en.htm

Kjo agjenci promovon dhe koordinon pajtueshmëri uniforme me rregullat e politikës së përbashkët të peshkimit, e në veçanti mbrojtjen e stoqeve të peshkut.

Zyra Komunitare për Llojet e Bimëve (ZKLB)

Vendi: Angers, Francë
www.cpvo.europa.eu

ZKLB administron një sistem të llojllojshmërisë së të drejtave të bimëve, ekuivalent me patentën për llojet e bimëve. Këto janë të mbrojtur për 25 apo 30 vite në varësi nga lloji i bimës.

Agjencia Ekzekutive Edukative, Audio-vizuale dhe Kulturore (AEEAK)

Vendi: Bruksel, Belgjikë
www.eacea.ec.europa.eu

Kjo agjenci menaxhon aspektet praktike të programeve të BE-së që ofrojnë fonde për rininë, programet e studentëve dhe mësuesve, dhe aktivitetet kulturore dhe mediatike.

Eurojust

Vendi: Hagë, Holandë
www.eurojust.europa.eu

Eurojust ndihmon hetuesit dhe prokurorët përgjatë tërë BE-së në punën e përbashkët të luftimit të krimit ndërkufitar. Luan rol në shkëmbimin e informacioneve dhe ekstradimit.

Agjencia Evropiane për Menaxhimin e Koordinimit Operacional në Kufijtë e Jashtëm të Shteteve Anëtare të BE-së (Frontex)

Vendi: Varshavë, Poloni
www.frontex.europa.eu

Frontex asiston vendet e BE-së në implementimin e rregullave të BE-së mbi kontrollin konsistente të kufijve të jashtëm dhe kthimin e imigrantëve ilegal në vendet e tyre të origjinës.

Agjencia Evropiane për Rindërtim (AER)

Lokacioni: Selanik, Greqi
www.eaer.europa.eu

AER menaxhon programet e BE-së për ofrimin e asistencës në rindërtim, zhvillim ekonomik dhe social, vendeve të Ballkanit të dëmtuara nga lufta.

Agjencia Evropiane për Siguri dhe Mbrojtje Shëndetësore në Punë (AESMSP)

Vendi: Bilbao, Spanjë
www.osha.europa.eu

Kjo agjenci mbledhë dhe ngritë vetëdijen për njohuritë dhe informacionet për sigurimin dhe mbrojtjen shëndetësore në punë, me theks në

krijimin e një kulture për parandalim efikas.

Agjencia Evropiane për Siguri në Aviacion (AESA)

Vendi: Kolonjë, Gjermani

www.easa.europa.eu

AESA promovon standardet më të larta të mundshme të sigurisë dhe mbrojtjes mjedisore në aviacionin civil të BE-së, dhe ofron certifikata për aeroplanë dhe komponente.

Qendra Evropiane për Zhvillim të Trajnimit Profesional (Cedefop)

Vendi: Selanik, Greqi

www.cedefop.europa.eu

Qendra promovon zhvillimin e arsimit dhe aftësimit profesional. Është qendër e ekspertizës për shpërndarjen e njohurisë dhe mbështetjes për politikë-bërje.

Qendra Evropiane për Parandalim dhe Kontroll të Sëmundjes (OEPKS)

Vendi: Stokholm, Suedi

www.ecdc.europa.eu

OEPKS identifikon, vlerëson dhe ofron informacione për kërcënimet aktuale dhe ato që do shfaqen për shëndetin e njeriut, nga sëmundjet ngjitëse, sikur është influenza, SARS dhe HIV/AIDS.

Agjencia Evropiane e Kemikaleve (AEK)

Vendi: Helsinki, Finlandë

www.ec.europa.eu/echa

Kjo agjenci menaxhon aspektet teknike, shkencore dhe administrative të REACH, sistemit të BE-së të regjistrimit të kemikaleve.

Agjencia Evropiane e Mbrojtjes (AEM)

Vendi: Bruksel, Belgjikë

www.eda.europa.eu

AEM ndihmon në promovimin e koherencës, në vend të fragmentarizmit të aftësive mbrojtëse dhe të sigurisë s Evropës, përfshirë në armatim dhe pajisje, hulumtim dhe operacione.

Agjencia Evropiane e Mjedisit (AEM)

Vendi: Kopenhagë, Danimarkë

www.eea.europa.eu

AEM i ofron politikëbërësve dhe publikut informacione për të ndihmuar promovimin e zhvillimit të qëndrueshëm dhe përmirësimin e mjedisit të Evropës.

Autoriteti Evropian i Sigurisë së Ushqimit (AESU)

Vendi: Parma, Itali

www.efsa.europa.eu

Autoriteti i ofron Komisionit dhe publikut këshilla të pavarura shkencore për sigurinë e ushqimit dhe rreziqet në zinxhirin e ushqimit 'nga ferma në pirun'.

Fondacioni Evropian për Përmirësimin e Kushteve të Jetës dhe Punës (Eurofound)

Vendi: Dublin, Irlandë

www.eurofound.europa.eu

Fondacioni është një e informacionit për çështjet e politikës sociale, përfshirë punësimin dhe kushtet e punës, marrëdhëniet industriale dhe partneritetin, dhe kohezionin social.

Autoriteti Evropian i Sistemit Satelitor të Navigimit Global (GSA)

Vendi: Bruksel, Belgjikë (selia e përkohshme)

www.ec.europa.eu/transport/gsa

Kjo agjenci menaxhon programet Evropiane të navigimit satelitor (veçanërisht Galileo dhe EGNOS), që po i japin Evropës aftësinë vetanake dhe teknologjinë më të re të kësaj fushe.

Instituti Evropian për Barazi Gjinore

Vendi: Vilnius, Lituani

Ky institut i ri promovon barazinë gjinore, përfshirë bërjen e çështjeve gjinore temë kryesore, dhe mbështet luftën kundër diskriminimit gjinor.

Agjencia Evropiane për Sigurinë

Detare (AESD)

Vendi: Lisbonë, Portugal

www.emsa.europa.eu

AESD i ofron Komisionit dhe vendeve të BE-së këshilla teknike dhe shkencore për përmirësimin e sigurisë së përgjithshme dhe asaj fizike në det dhe parandalimin e ndotjes së detit.

Agjencia Evropiane e Medicinës (AEM)

Vendi: Londër, Mbretëria e Bashkuar

www.emea.europa.eu

AEM këshillon Komisionin kur ilaçet për njerëz dhe veterinar janë të gatshme të plasohen në tregun e BE-së. I monitoron kundër-efekte, dhe ofron këshilla shkencore.

Qendra Evropiane Monitoruese për Drogën dhe Varshmërinë ndaj Drogës (OEI/DVD)

Vendi: Lisbonë, Portugal

www.emcdda.europa.eu

Kjo qendër është burim i informatave objektive, të besueshme dhe të krahasueshme për drogat dhe varshmërinë ndaj drogës në mënyrë që tu ndihmohet politikë-bërësve në identifikimin e problemeve dhe qëllimeve.

Agjencia Evropian e Rrjetit dhe Sigurisë së Informacionit (AERSI)

Vendi: Heraklion (Kretë), Greqi

www.enisa.europa.eu

AERSI ndihmon që rrjetet e informatave dhe të të dhënave që barten janë të sigurta duke mbledhur informata, analizuar rreziqe, dhe ngritje të vetëdijes dhe promovimit të praktikës së mirë.

Kolegji i Policisë Evropiane (CEPOL)

Vendi: Bramshill, Mbretëri e Bashkuar

www.cepol.net

Kolegji trajnon zyrtarët e larët policor të BE-së dhe përgatitë programe të trajnimit për oficerët e rangut të mesëm, me theks të veçantë në luftimin e krimit

ndër-kufitar.

Zyra e Policisë Evropiane (Europol)

Vendi: Hagë, Holandë

www.europol.europa.eu

Europol mëton përmirësimin e efikasitetit dhe bashkëpunimit të autoriteteve të zbatimit të ligjit në vendet e BE-së në luftën e tyre kundër krimit të organizuar ndërkombëtar.

Agjencia Evropiane e Hekurudhave (AEH)

Vendi: Lilë/Valenciennes, Francë

www.era.europa.eu

Kjo agjenci punon në qaje të përbashkët të sigurisë së hekurudhave dhe standardeve të përbashkëta për ndër-operacionet e hekurudhave për të shtruar rrugën për një rrjet tërësisht të integruar të BE-së.

Fondacioni Evropian i Trajtimeve (FET)

Vendi: Torino, Itali

www.etf.europa.eu

FET ndihmon në përmirësimin e trajnimit profesional në vendet jashtë BE-së, kryesisht rreth Mesdheut, në Evropën lindore dhe Rusi.

Agjencia Evropiane për të Drejtat Themelore (AEDT)

Vendi: Vjenë, Austri

www.fra.europa.eu

Kjo agjenci mbledhë dhe shpërndan objektiva, dhe informacione krahasimore mbi çështjet e të drejtave themelore, dhe këshillon si të promovohen këto të drejta. Mund të jetë racizmi dhe ksenofobia por poashtu edhe të drejta tjera themelore.

Instituti i Bashkimit Evropian për Studime të Sigurisë (EIBESS)

Vendi: Paris, Francë

www.iss-eu.org

Instituti mëton të ndihmojë në krijimin e një kulture të përbashkët Evropiane të sigurisë, për të pasuruar

debatën strategjik, dhe në mënyrë sistematike promovon interesat e sigurisë së Bashkimit Evropian.

Qendra Satelitore e Bashkimit Evropian (QEBE)

Vendi: Torrejón de Ardoz, Spanjë
www.eusc.europa.eu

Kjo qendër mbledhë dhe analizon të dhënat dhe imazhet nga satelitët vrojtues të tokës në mbështetje të prioritetave të politikës së jashtme dhe të sigurisë së BE-së dhe aktivitetave humanitare.

Agjencia Ekzekutive për Programin e Shëndetit Publik (AEPSP)

Vendi: Luksemburg
www.ec.europa.eu/phea

AEPSP menaxhon praktikat e programeve të financimit të BE-së për projektet e shëndetit publik, dhe i ushqen rezultatet prapa te palët me interes për shëndetin publik dhe vendim-marrësit.

Zyra për Harmonizim të Tregut të Brendshëm (Markat Tregtare dhe Dizajnet) (ZHTM)

Vendi: Alicante, Spanjë
www.oami.europa.eu

Zyra regjistron markat tregtare dhe dizajnet. Këto janë pastaj valid për gjatë të tërë BE-së. Ky sistem ekziston krah për krah me sistemet vendore të regjistrimit të vendeve të BE-së.

Qendra e Përkthimit për Organet e Bashkimit Evropian (QPOBE)

Vendi: Luksemburg
www.cdt.europa.eu

Qendra ofron shërbime të përkthimit për agjencitë e specializuara të BE-së.



© Van Parys Media

Agjencia Evropiane për Siguri në Aviacion është duke punuar që ta bëjë fluturimin gjithnjë e më të sigurtë dhe të përbalueshëm për mjedisin.

Komisioni Evropian

Si funksionon Bashkimi Evropian **Udhërrëfyesi i juaj për institucionet e BE-së**

Luksemburg: Zyra e publikimeve zyrtare të Komuniteteve Evropiane

2007 – 46 fq. – 16.2 x 22.9 cm

ISBN-13 978-92-79-11298-0

Bashkimi Evropian (BE) është unik. Nuk është shtet federal si Shtetet e Bashkuara të Amerikës pasi që vendet anëtare të tij mbeten kombë të pavarura sovraane. E as që është organizatë e pastër ndër-qeveritare sikur Kombet e Bashkuara pasi që vendet anëtare japin pak nga sovraniteti i tyre- dhe rrjedhimisht marrin më shumë fuqi dhe influencë kolektive se që ata do kishin nëse do vepronin në mënyrë individuale.

Ata e bashkojnë sovranitetin e tyre duke marrur vendime të përbashkëta përmes institucioneve të përbashkëta sikur janë Parlamentin Evropian, që është i zgjedhur nga qytetarët e BE-së, dhe Këshilli, i cili përfaqëson qeveritë nacionale. Ata vendosin në bazë të propozimeve të Komisionit Evropian, që përfaqëson interesat e BE-së si të tërë. Mirëpo çfarë bëjnë secila nga këto institucione? Si funksionojnë ato së bashku? Kush është përgjegjës për qka?

Kjo broshurë ofron përgjigje në gjuhë të qartë dhe të thjeshtë. Poashtu jep një pasqyrë të shkurtër për agjencitë dhe organet tjera të përfshira në punën e Bashkimit Evropian. Qëllimi është që t'ju ofrojmë një udhërrëfyes të dobishëm lidhur me vendim-marrjen në Bashkimin Evropian.

Informata të tjera mbi Bashkimin Evropian

Hapeni internetin

Informatat në të gjitha gjuhët zyrtare të Bashkimit Evropian dhe mundësitë për të na treguar se çka mendoni mund t'i gjeni në faqen: europa.eu



Ejani dhe na vizitoni

Në Evropë ka disa qendra lokale informative të BE-së. Adresën e qendrës më të afërt mund ta gjeni përmes faqes: europedirect.europa.eu



Na telefononi ose na shkruani

EUROPE DIRECT është shërbim që përgjigjet në pyetjet tuaja mbi Bashkimin Evropian. Këtë shërbim mund ta kontaktoni përmes linjës telefonike pa pagesë: 00 800 6 7 8 9 10 11, telefoni me pagesë në raste të thirrjeve jashtë BE-së: (32-2) 299 96 96), ose përmes postës elektronike: europedirect.europa.eu



Lexoni mbi Evropën

Publikimet mbi BE-në janë vetëm një klikim larg në faqen e internetit të Librisë së BE-së: bookshop.europa.eu




Informata dhe broshura mbi BE-në gjithashtu mund të mirren nga:

Zyra ndërridhëse e Komisionit Evropian në Kosovë

Rr. Kosova 1, Fahu postar 331
Pristinë, Kosovë
Poste: 38 6151 200
Tel.: +383 46 313 1305
Web: ec.europa.eu
Email: ec-liaison-office-kosovo@ec.europa.eu

Bashkimi Evropian



Si funksionin Bashkimi Evropian

Udhërrëfyesi juaj për institucionet e BE-së

JU-81-08-517-SQ-C

SQ



Bashkimi Evropian (BE) është unik. Nuk është shtet federal si Shtetet e Bashkuara të Amerikës pasi që vendet anëtare të tij mbeten kombe të pavarura sovraane. E as që është organizatë e pastër ndër-qeveritare sikur Kombet e Bashkuara pasi që vendet anëtare japin pak nga sovraniteti i tyre- dhe rrjedhimisht marrin më shumë fuqi dhe influencë kolektive se që ata do kishin nëse do vepronin në mënyrë individuale.

Ata e bashkojnë sovranitetin e tyre duke marrur vendime të përbashkëta përmes institucioneve të përbashkëta sikur janë Parlamenti Evropian, që është i zgjedhur nga qytetarët e BE-së, dhe Këshilli, i cili përfaqëson qeveritë nacionale. Ata vendosin në bazë të propozimeve të Komisionit Evropian, që përfaqëson interesat e BE-së si të tërë. Mirëpo çfarë bëjnë secila nga këto institucione? Si funksionojnë ato së bashku? Kush është përgjegjës për çka?

Kjo broshurë ofron përgjigje në gjuhë të qartë dhe të thjeshtë. Poashtu jep një pasqyrë të shkurtër për agjencitë dhe organet tjera të përfshira në punën e Bashkimit Evropian. Qëllimi është që t'ju ofrojmë një udhërrëfyes të dobishëm lidhur me vendim-marrjen në Bashkimin Evropian.



Publications Office
Publications.europa.eu

